



Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr. 10
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës
T/F: +381 38 746 206
E: ridea.institute@gmail.com
W: www.ridea-ks.org

RRUGA E LËKUNDSHME E KOSOVËS DREJT BE-SË

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT: SFIDAT DHE MUNDËSITË

Prishtinë, Korrik 2013



Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr. 10
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës
T/F: +381 38 746 206
E: ridea.institute@gmail.com
W: www.ridea-ks.org

RRUGA E LËKUNDSHME E KOSOVËS DREJT BE-SË

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT: SFIDAT DHE MUNDËSITË

Përmbajtja

Akronimet.....	3
1. Hyrje.....	5
1.1. Metodologjia.....	5
1.2. Pyetësi.....	6
1.3. Grupi i synuar dhe përfituesit.....	6
2. Qasja e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor.....	6
2.1. Epoka pas Luftës së Ftohtë.....	6
2.2. Samiti i Zagrebit.....	8
2.2.1. Drejt Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim.....	8
2.2.2. Negocimi dhe implementimi i Marrëveshjeve për Stabilizim dhe Asociim.....	8
2.2.3. Asistenca.....	9
2.2.4. Samiti i Selanikut.....	10
2.2.5. Nën-përfundimet: Qasja e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor.....	10
3. Kosova përballë vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor në lidhje me MSA-në.....	11
3.1. Nën-përfundimet: Kosova përballë vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor në lidhje me MSA-në.....	14
4. Raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së (1999-2013).....	14
4.1. Raportet BE-Kosovë (1999 -2008)	14
4.2. Nën-përfundimet: Raportet BE-Kosovë (1999-2008).....	18
4.3. Raportet BE-Kosovë (2008-2013).....	18
4.4. Nën-përfundimet: Raportet BE-Kosovë (2008-2013).....	20
5. Sfidat dhe mundësitë e Kosovës gjatë fazës negociuese të MSA-së.....	21
5.1. Sfidat e përgjithshme.....	21
5.2. Sfidat Specifike.....	24
5.3. Nën-përfundimet: Sfidat dhe mundësitë e Kosovës gjatë fazës negociuese të MSA-së.....	25
6. Sfidat dhe mundësitë e Kosovës gjatë fazës eventuale të ratifikimit për MSA-në.....	25
6.1. Sfidat e Përgjithshme.....	26
6.2. Sfidat Specifike.....	28
6.3. Nën-përfundimet: Sfidat dhe mundësitë e Kosovës gjatë fazës eventuale të ratifikimit të MSA-së.....	29
7. Përfundimet.....	30

8. Rekomandimet.....	32
8.1. Rekomandimet në lidhje me <i>sfidat e përgjithshme</i> për fazën negociuese dhe ratifikuese të MSA-së.....	32
8.2. Rekomandimet në lidhje me <i>sfidat specifike</i> gjatë fazës negociuese dhe ratifikuese të MSA-së.....	34
9. Bibliografia.....	37
10. Anekset.....	43
10.1. Pyetëtori.....	43
10.2. Agjenda e Tryezës së Rrumbullakët.....	44

Akronimet

AER - Agjencioni Evropian për Rindërtim

AKRZHS –Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim

AREPH - Asistenca për Rindërtim Ekonomik në Poloni dhe Hungari

BE – Bashkimi Evropian

B&H – Bosnja dhe Hercegovina

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

EUPT - Ekipi Planifikues i BE-së për misionin e EULEX-it

GJNKJ - Gjykata Ndërkombëtare për Krime në ish-Jugosllavi

IPA – Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit

IRJM – Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

KE –Komisioni Evropian

MMBE - Misioni Monitorues i Bashkimit Evropian

MMKE - Misioni Monitorues i Komunitetit Evropian

MP – Marrëveshje e Përkohshme

MPS - Mekanizmi Përcjellës i Stabilizimit

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

NATO – Traktati i Organizatës të Atlantikut Verior

NVM - Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

PAS – Procesi i Stabilizim Asociimit

PE – Parlamenti Evropian

PL PPJS – Përfaqësues i Lartë për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë

PPE – Plani për Partneritet Evropian

PPJS - Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë

TARIK - Tarifa e Integruar për Kosovën

UNMIK – Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë

USAID – Agjencioni i SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtarë

ZCN - Zyra Civile Ndërkombëtare

ZNKE - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

1. Hyrje

Rëndësia e veçantë e këtij projekti lidhet me faktin që sukcesi i Kosovës në negocimin dhe ratifikimin e suksesshëm të MSA-së do të përmirësoj cilësinë e qeverisjes dhe jetës së qytetarëve të Kosovës.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është identifikimi i sfidave me të cilat Kosova do të ballafaqohet gjatë fazës negociuese dhe eventualisht ratifikuese të MSA-së me BE-në. Për më shumë, ky studim ka për qëllim të paraqet mundësitë, procedurat, proceset (mënyrat dhe hapat dhe mjetet e nevojshme) me të cilat Qeveria e Kosovës mund të lëviz përpara gjatë këtij procesi.

Kështu që, pjesa e parë e këtij studimi paraqet në sfond përfshirjen e BE-së në Ballkanin Perëndimor që nga viti 1997 deri më sot. Kjo vijon me një analizë në lidhje me raportet e Kosovës me BE-në, duke krahasuar me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Pastaj, pjesa tjetër e këtij studimi analizon raportet BE-Kosovë në dy periudha të ndara (1999-2008) dhe (2008-2013). Mëtej, duke u bazuar në analizën dhe diskutimin paraprak, pjesa vijuese e këtij studimi analizon sfidat me të cilat Kosova mund të ballafaqohet gjatë fazës negociuese dhe eventualisht ratifikuese të MSA-së me BE-në. Kjo pjesë mbështetet me shembuj dhe përvoja nga vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, dhe mësimet që mund të nxjerr Kosova në këtë aspekt.

Rezultati përfundimtar i projektit është ky studim në formë të një raporti gjithëpërfshirës që synon të mbështet qeverinë e Kosovës, në veçanti Ministrinë e Integritimit Evropian si mjet i besueshëm në procese të politikë-bërjes. RIDEA do të ndërmerret të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që ky raport arrin tek të gjithë akterët relevant.

1.1. Metodologjia

Me qëllim të arritjes së rezultateve të pritura të projektit, tri mjete hulumtuese janë shfrytëzuar:

Së pari, intervistat elitare që janë mbajtur me akterët relevant vendor dhe ndërkombëtar në Kosovë. Në veçanti, personat e intervistuar për këtë studim paraqesin ose përfaqësojnë institucionet vijuese:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës;
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës (në veçanti Komiteti i Integritimit Evropian);
3. Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës;
4. Organizatat e shoqërisë civile dhe akademike në Kosovë;
5. Prania e BE-së në Kosovë (në veçanti Zyra e BE-së në Kosovë); dhe
6. Prania diplomatike e shteteve anëtare të BE-së, dhe prania e partnerëve tjerë relevant ndërkombëtar në Kosovë;

Së dyti, lidhet me diskutimet në tryezë të rrumbullakët që janë organizuar me partnerë të ndryshëm relevant vendor dhe ndërkombëtar; dhe

Së treti, ka të bëjë me procesin e mbledhjes dhe analizës së raporteve të organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare (p.sh. raporti vjetor i progresit të Komisionit Evropian) dhe artikuj tjerë akademik.

1.2. Pyetësi

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të hapit të parë dhe vendimtar të projektit – intervistave – ishte e nevojshme formulimi i një numri pyetjeve specifike, që do të rezultonte në arritjen e synimeve të projektit. Në këtë mënyrë, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme dhe arritjes së qëllimeve të projektit, RIDEA ka përpiluar një pyetësor gjithëpërfshirës e cila përbëhet nga më se 20 pyetje. Teksti i plotë i pyetësorit së bashku me agjendën e tryezës së rrumbullakët janë të bashkangjitur në formë të aneksit në këtë raport.

1.3. Grupi i synuar dhe përfituesit

Grupi kryesor i synuar në projekt përbëhet nga individë, politikë-bërës dhe shkollat të angazhuar në procese të integritimeve Evropiane. Më gjerësisht, grupi i synuar përbëhet nga studentë, kërkues dhe ekspertë tjerë aktiv në procese të integritimeve Evropiane. Përfituesi kryesor i studimit është qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera (p.sh., Kuvendi i Kosovës), dhe në veçanti Ministria e Integritimit Evropian. Përfitues tjerë të mundshëm janë organizatat e shoqërisë civile të përfshira në procese të integritimeve Evropiane, prania ndërkombëtare në Kosovë (në veçanti prania e BE-së). Për më shumë, ky studim mund të jetë i dobishëm për donator të mundshëm ose institucione tjera kërkuese të kësaj fushe.

2. Qasja e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor

2.1. Epoka pas Luftës së Ftohtë

Me rënien e regjimeve Komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore janë shfaqur mundësi të reja për zgjerim të mëtejshëm të Bashkimit Evropian. Më 1993, Këshilli Evropian në Kopenhagë ka marrë një vendim të rëndësishëm në lidhje me ofrimin e anëtarësimit për të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në rast të përmbushjes së kriterëve të caktuara. Në të vërtetë, Kriteret e Kopenhagës përfshijnë funksionimin e demokracisë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, të drejtat e pakicave dhe funksionimin e ekonomisë së tregut. Prandaj, Marrëveshjet për Asociim janë nënshkruar nga dhjetë vendet e rajonit.¹ Këto marrëveshje të quajtura ‘Evropa’ kanë obliguar shtetet të harmonizojnë legjislacionin e tyre me standarde të BE-së, me qëllim të

¹ Qerimi, Q. (2002) ‘Integrimi i Evropës Jug-lindore në BE: Ëndrra dhe realitete’, *Rishqyrtimi i Evropës Jug-Lindore*, Vëll. 1 Nr. 1, fq. 47.

modernizimit të administratës së tyre. Në vitin 1998 gjashtë vende kanë filluar negociatat (Estonia, Polonia, Republika e Çekisë, Hungaria, Sllovenia dhe Qipro). Komisioni kishte rekomanduar që negociata tjera duhet të hapen me vendet si: Malta, Letonia, Lituania dhe Sllovakia. Shtetet e para të Evropës Qendrore dhe Lindore iu bashkuan Bashkimit Evropian në vitin 2004. Përveç Sllovenisë, deri atëherë asnjë vend nga ish Jugosllavia Socialiste nuk kishte fituar anëtarësim të plotë në BE.²

Sa i përket Ballkanit Perëndimor, si pasojë e luftërave në ish-Jugosllavi, BE-ja filloi zhvillimin e një strategjie më koherente në rajon. Elementet e para të kësaj strategjie kanë filluar menjëherë pas Konferencës së Romës, 18 shkurt 1996, në bazë të kornizës së BE-së për Qasje Rajonale. Nëpërmjet këtij programi, BE-ja ofroi përkrahje teknike, preferenca të njëanshme tregtare dhe marrëdhënie kontraktuale në formë të marrëveshjeve bashkëpunuese bilaterale në rast të përkushtimit në reforma politike dhe ekonomike, përmbushjes së kushteve specifike të vendit dhe ‘pajtim me obligimet sipas Marrëveshjeve për Paqe’.³

Me fjalë të tjera, me qëllim të nxitjes së reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor, BE-ja zbatoi një qasje graduale ndaj rajonit. Kjo qasje nënkupton se përfitimet nga përkrahja teknike dhe financiare janë subjekt i shkallëve të ndryshme të kushtëzimit. Në fakt, në rast të progresit në kushtet e përcaktuara, shteti shpërblehet me bashkëpunim të intensifikuar bilateral që shpie në marrëdhënie kontraktuale. Në të kundërtën, në rast të mos-përmbushjes së kushteve, ‘masave specifike’ do të rezultojnë në tërheqjen e përkrahjes teknike dhe financiare.⁴

Megjithatë, një ndryshim rrënjësor në kursin e veprimit të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor paraqitet pas luftës në Kosovë më 1999. Me sa duket, liderët e BE-së kuptuan që strategjia me qëllim të rindërtimit ekonomik, reformave politike dhe bashkëpunimit rajonal nuk mjafton në ofrimin e paqes së qëndrueshme në rajon, por vetëm integrimi i plotë në BE, duket të jetë mënyra më e mirë për të arritur këtë.⁵

Në këtë mënyrë, Bashkimi Evropian identifikon përgjegjësitë e saj në rajon dhe përkushtohet në nxitje të reformës politike dhe ekonomike.⁶ Në thelb, zgjerimi i BE-së ka të bëjë me nxitjen e stabilitetit dhe rrugës së zhvillimit. Ka të bëjë me zgjerimin ekskluziv të zonës së lirisë, paqes, dhe stabilitetit, që është rritur vazhdimisht nga Evropa Perëndimore në Evropën Lindore për më shumë se gjashtë dekada.⁷ Shtetet që janë angazhuar në negociata për marrëveshje me Bashkimin Evropian kanë kuptuar që duhet të zgjidhin konfliktet me fqinjët e tyre nëse duan të aderojnë në

² Po aty.

³ Pippan, C. (2004) 'Rruga e lëkundshme drejt Evropës: Procesi i Stabilizim Asociimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Parimi i Kushtëzimit', *Rishqyrtimi i Çështjeve të Jashme Evropiane* 9, fq. 219–245.

⁴ Po aty.

⁵ Po aty.

⁶ Voss, J. (2002) 'Bashkimi Evropian dje, sot dhe nesër'. *Rishqyrtimi Euro-Atlantik*, Vëll. 1 Nr. 1, fq. 48.

⁷ Biermann, R. (2002) 'Perspektiva e Robert Schuman për Paqe dhe Stabilitet nëpërmjet Pajtitimit'. *Rishqyrtimi Euro-Atlantik*, Vëll. 1 Nr. 1, fq. 71.

Bashkimin Evropian. Shembulli i mirë në këtë aspekt ishte bashkëpunimi ndërmjet Hungarisë dhe Rumanisë, gjithashtu kursi i veprimit të Kroacisë ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Sllovenisë është shembulli tjetër.⁸

Në të vërtetë, Këshilli Evropian në Feira, qershor të vitit 2000, konkludoi që raportet me BE-në të bazuara në perspektivë për anëtarësim janë nxitja kryesore për këto lloje të reformave në vendet e Ballkanit, duke përfshirë vendosjen e demokracisë, sundimit të ligjit dhe, zhvillimit të institucioneve të qëndrueshme dhe funksionimit të ekonomisë së tregut të lirë. Vendet e Evropës Jug-Lindore duhet të pranojnë që nuk mjafton vetëm orientimi ndaj BE-së, por duhet të pranojnë nevojën për marrëdhënie të mira bilaterale të cilat hapin rrugë për stabilitet më të madh ekonomik dhe politik në rajon.⁹

2.2. Samiti i Zagrebit

Në Samitin e Zagrebit, në nëntor të vitit 2000, BE-ja dhe shtetet e rajonit pajtohen për të vazhduar Procesin e Stabilizim Asociimit (mëpastaj: PAS) si mënyrë për të përgatitur rajonin për reforma të qëndrueshme dhe proces të integrimit në BE. Ky proces përbëhet nga tri faza kryesore:

- a. Drejt Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim;
- b. Negocimi dhe implementimi i Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim;
- c. Asistenca.¹⁰

2.2.1. Drejt Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim

Hapat kryesor të përkushtimit afat-gjatë drejt BE-së lidhen me Marrëveshjet për Stabilizim dhe Asociim (mëpastaj: MSA). Në fakt, politika e BE-së e bazuar në Kriteria të Kopenhagës për hapat drejt reformës politike dhe ekonomike ofron hapjen e tregut; që poashtu ofron një mbështetje financiare dhe politike ndaj shteteve respektive.¹¹ Këto shtete duhet të tregojnë përmirësim serioz në agjendën e reformave ekonomike dhe politike, si dhe duhet të tregojnë vullnet për kalimin e pengesave për paqe dhe stabilitet brenda rajonit, që mëpastaj, negociatat për marrëveshje të tillë të mund të fillojnë.¹²

2.2.2. Negocimi dhe implementimi i Marrëveshjeve për Stabilizim dhe Asociim

⁸ Po aty.

⁹ Shih fusnotën nr. 1.

¹⁰ Shih fusnotën nr. 6.

¹¹ Shih fusnotën nr. 1.

¹² Po aty.

Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit (MSA-të) janë krijuar pas Marrëveshjeve ‘Evropa’ të nënshkuara me dhjetë shtete të Evropës qendrore dhe lindore në vitet e 90-ta. MSA-ja si marrëdhënie kontraktuale është marrëveshje ndërkombëtare ligjore, që kërkon miratimin nga Parlamenti Evropian (PE).¹³ MSA-të përqendrohen në respektim të parimeve dhe vlerave kyçe demokratike dhe respektim të bazave të tregut unik në BE. Nëpërmjet marrëveshjeve të lira tregtare me BE-në, fillon procesi i integritimit të ekonomive të vendeve respektive me atë të BE-së. MSA-të përshtaten me situatën e secilit vend. Sidoqoftë, të gjithë kanë si qëllim përfundimtar, anëtarësimin e plotë pas një periudhe të implementimit të kriterëve bazë dhe/ose kërkesave.¹⁴ Në fund të fundit, është më se e qartë se integrimi i plotë në struktura të BE-së kërkon një përkushtim afat-gjatë nga të dyja palët. Prandaj, për t’u ballafaquar me këtë sfidë BE-ja ka zhvilluar një kornizë politike më të sofistikuar – PAS duke transformuar Qasjen Rajonale që ekzistonte.¹⁵ Ky proces përfshin propozime të modifikuara dhe të reja, në fushën e liberalizimit të tregut, mbështetjes financiare dhe ekonomike. Ky proces, ndryshoi natyrën e marrëdhënieve kontraktuale të propozuara – duke zëvendësuar perspektivën e Marrëveshjes për Bashkëpunim me atë të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim.¹⁶

2.2.3. Asistenca

Me samitin e Zagrebit është lansuar edhe një program i ri i BE-së, i quajtur Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (më pastaj: AKRZHS), me një shumë prej 4.65 EUR miliardë për periudhën 200-2006. Vendet e rajonit që kishin përbushur obligimet e Fazës 1 dhe Fazës 2 merrnin asistencë më të madhe nga BE-ja. Derisa programi i asistencës për Ballkanin Perëndimor quhej AKRZHS (2000-2006), programi AREPH ishte për vendet e zgjerimit të pestë të BE-së. Programi AKRZHS synon përbushjen e nevojave të secilit vend në rrugën e saj gjatë PAS. Roli dhe fokusi kryesor i asistencës koordinohet në bazë të nevojave të secilit vend dhe përkrahjes për reforma, ndërtim institucional dhe bashkëpunim rajonal. Me fjalë tjera, qëllimi kryesor i AKRZHS ishte promovimi dhe përkrahja e ndërtimit të kapaciteteve institucionale, zhvillimit ekonomik dhe bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor.¹⁷ Që nga viti 2007, fondet e para-anëtarësimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor, si dhe për vendet tjera kandidate, kanalizohen nëpërmjet një Instrumenti të vetëm, unik, të Asistencës së Para-anëtarësimit (mëpastaj: IPA). Në thelb, IPA zëvendësoi programin AKRZHS (2000-2006). Fondi

¹³Parlamenti Evropian (2011) *Vendet e Ballkanit Perëndimor*. E disponueshme: http://www.europarl.europa.eu/aboutparliament/en/displayFtu.html?ftuId=FTU_6.4.1.html (vizituar më: 30/06/2013).

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Shih fusnotën nr. 3.

¹⁶ Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2000) *Komunikatë nga Komisioni për Këshillin për Konkluzionet Operative të procesit të Stabilizim Asociimit të BE-së për vendet e Evropës Jug-Lindore..* E disponueshme: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2000:0049:FIN:EN:PDF> (vizituar më: 30/06/2013).

¹⁷ Shih fusnotën nr. 13.

total i para-anëtarësimit për kornizën aktuale financiare (2007-13) është 11.5 miliardë Euro.¹⁸ Sa i përket objektivave, ato të IPA-së janë të ngjashme me të programit AKRZHS.

Raportet që ekzistojnë ndërmjet shteteve anëtare të BE-së duhet të jenë inkurajuese dhe të shërbejnë si model për vendet e rajonit që të zhvillojnë raporte me njëra tjetrën. Këtu mbështetje të fuqishme gjen rrjeti i marrëveshjeve bilaterale për tregti të lirë. Edhe pse nevojitet një kohë e gjatë, perspektiva e anëtarësimit të plotë të vendeve të Ballkanit Perëndimor është e bazuar në fakte. Sidoqoftë, duhet të theksohet që anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon përkushtim që të gjitha shtetet të jenë të hapura dhe tolerante ndaj njëra tjetrës. Kushti paraprak për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian është tejkalimi i konflikteve vdekje-prurëse ndërmjet popujve në rajon. Vendet e rajonit duhet të kuptojnë që bashkëjetesa paqësore është si parakusht i stabilitetit ekonomik dhe politik.¹⁹

2.2.4. Samiti i Selanikut

Një moment tjetër i rëndësishëm në raportet ndërmjet BE-së – Ballkanit Perëndimor është Samiti i Selanikut, që rikonfirmon perspektivën e anëtarësimit të rajonit në BE. Më konkretisht, Këshilli Evropian në Selanik, qershor të vitit 2003, premtoi një vend në familjen Evropiane për Ballkanin Perëndimor. Udhëheqësit e shteteve dhe qeverive të BE-së përkushtohen që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të kenë perspektivën e anëtarësimit eventual në BE, dhe që mund të bëhen pjesë e familjes Evropiane pas përmbushjes së kriterëve të përcaktuara.

Në njërin anë, stabiliteti politik në vend është i domosdoshëm për një të ardhme më të mirë për njerëzit, derisa hapja dhe konkurrenca e rëndësishme mund ta shndërrojë rajonin në një magnet të investimeve të jashtme dhe bartjes së njohurive. Sidoqoftë, sikurse politikat e orientuara në biznes që janë të përcaktuara mirë, vendimtare për suksesin e rimëkëmbjes ekonomike është stabiliteti i mjaftueshëm makroekonomik dhe politik në nivel rajonal. Poashtu, përfundimi i privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha dhe shërbimeve; dhe krijimi i kushteve të nevojshme për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

2.2.5. Nën-përfundimet: Qasja e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor

Siç tregohet, një numër kriteresh të zbatueshme për vendet e Ballkanit përfshijnë kriteret e përcaktuara nga Këshilli Evropian i Kopenhagës të vitit 1993 dhe kushtet e përcaktuara në PAS, veçanërisht kushtet e Këshillit të specifikuar në konkluzionet e saj të 24 prillit 1997 dhe 21 dhe 22 qershorit 1999, përmbajtja e deklaratës përfundimtare të Samitit të Zagrebit më 24 nëntor 2000, dhe Agjenda e Selanikut 19 dhe 20 qershor 2003. Këshilli Evropian përsërit pozicionin e tij në qershor të vitit 2005:

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Shih fusnotën nr. 1.

“Progresi i secilit vend në integrimin Evropian, duke pasur parasysh vlerësimet e acquis, varet nga përpjekjet e tij për t’i zbatuar kriteret e Kopenhagës dhe kushtëzimet nga procesi i Stabilizim Asociimit. Për më shumë, në këtë proces, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore mbeten elemente kryesore të politikës së BE-së.”

Prandaj, vlerësimi i progresit të secilit vend bëhet nëpërmjet mekanizmave të përcaktuar sipas PAS, veçanërisht Raportit të Progresit vjetor të Komisionit. Prosesi integrues përmban edhe elemente të kushtëzimit. Ky kushtëzim zbatohet në aspektin e ndihmës financiare. Përparimi i secilit vend të Ballkanit Perëndimor në procesin e integrimit Evropian kushtëzohet me progresin e bërë në përmbushje të kriterëve të Kopenhagës, progresit në përmbushje të prioritetëve specifike të Partneritetit Evropian, si dhe nga ndërmarrja e reformave demokratike, ekonomike dhe institucionale të vendit. Në rast të mos-përmbushjes së kushteve të tilla, Këshilli mundet sipas Rregullës së Këshillit (KE) Nr. 2666/2000 që të merr masa të ‘përshtatshme’, që mund të jenë shtyrja, ndalimi ose zvogëlimi i ndihmës së BE-së.

3. Kosova përballë vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor në lidhje me MSA-në

Kushtet për fillim të negociatave për MSA-në janë paraqitur në Konkluzionet e Këshillit të 29 prillit 1997. Nëse kushtet janë përmbushur, fillon me, ‘studimin e fizibilitetit’ të secilit vend individualisht, duke vlerësuar pajtimin me kushtet relevante. Në rast të vlerësimit pozitiv nga Këshilli, Komisioni përcakton një propozim zyrtar mbi direktivat negociuese për MSA-në.²⁰

Nëse pranohet nga Këshilli, negociatat implementohen nga Komisioni në konsultim me një komitet special të krijuar nga Këshilli për qëllime të tilla.

Negociatat për MSA-të dhe ratifikim të saj mund të konsiderohen si një proces afat-mesëm. Në rast të nënshkrimit, perspektiva e vendit për aderim varet nga implementimi efektiv i MSA-së. Që të bëhet marrëveshja efektive, duhet të ratifikohet dhe konkludohet nga Shtetet Anëtare dhe Komunitetet Evropiane. Sot, MSA-të janë nënshkruar dhe ratifikuar me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë dhe Malin e Zi.

²⁰ Komisioni i Komuniteteve Evropiane (1999) *Komunikatë nga Komisioni për Këshillin dhe Parlamentin Evropian për procesin e Stabilizim-Asociimit për vendet e Evropës Jug-Lindore*. E disponueshme: <http://aei.pitt.edu/3571/1/3571.pdf> (vizituar më: 30/06/2013).

Vendet e para që kanë pranuar direktivat negociuese për Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit janë ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)²¹ dhe Kroacia²² në vitin 2000. Ky proces, në të njëjtin vit, është pasuar me vijim të negociatave. Derisa të dy vendet kanë nënshkruar MSA-në në vitin 2001, marrëveshja me IRJM hyri në fuqi në shtator 2004, ndërsa me Kroacinë në shkurt 2005. Pra, në rastin e IRJM-ës²³ dhe Kroacisë²⁴ procesi negociues zgjati rreth një vit. Derisa procesi ratifikues në rastin IRJM dhe Kroacisë zgjati përafërsisht 3 vite tjera.²⁵

Në rastin e Shqipërisë²⁶, mandati për negociim të MSA-së është miratuar në tetor 2002 derisa negociatat zyrtarisht kanë filluar në janar 2003. Ngjashëm, mandati negociues për Bosnjën dhe Hercegovinën (B&H)²⁷ zyrtarisht filloi në tetor 2005. Derisa Shqipëria²⁸ nënshkroi MSA-në në qershor 2006, B&H²⁹ nënshkroi në qershor 2008. Prandaj, procesi negociues për dy vendet zgjati rreth tri vite. Marrëveshja hyri në fuqi vitin e njëjtë që është nënshkruar, respektivisht 2006 dhe 2008. MSA-ja me Shqipërinë hyri në fuqi në vitin 2009, derisa për B&H edhe pse është ratifikuar në vitin 2010 nga të gjitha shtetet anëtare, nuk ka hyrë në fuqi ende. Sa i përket Serbisë³⁰ dhe Malit të Zi, negociatat për MSA kanë filluar në tetor 2005. Megjithatë, në maj 2006 negociatat me Serbinë³¹ ishin anuluar për shkak të mos-bashkëpunimit me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë (mëpastaj: GJNKJ). Por, rreth një viti më vonë, me përmirësim të bashkëpunimit me GJNKJ, negociatat ri-filluan. Marrëveshja me Malin e Zi³² është nënshkruar në tetor 2007 derisa me Serbinë në prill 2008. Derisa marrëveshja me Malin e Zi³³ është ratifikuar në të njëjtin vit, në rastin e Serbisë³⁴ procesi i ratifikimit ka zgjatur rreth dy

²¹ Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/former-yugoslav-republic-of-macedonia/index_en.htm (vizituar më 30/06/2013).

²² Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Kroacia*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/croatia/index_en.htm (vizituar më 30/06/2013).

²³ Shih fusnotën nr. 21.

²⁴ Shih fusnotën nr. 22.

²⁵ Markiewicz, M. dhe Ivana, V. (2006) *Kostot potenciale fiskale të Malit të Zi për pranimin në BE. Punim serik në letër. Instituti për Studime Strategjike dhe Prognozë*. E disponueshme: http://issp.me/wp-content/uploads/2013/04/2006-WP_Fiscal-Cost-of-EU-Accession.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

²⁶ Komisioni Evropian (2012) *Vendet në Zgjerim, datat kyçe në rrugën e Shqipërisë drejt BE-së*. E disponueshme: http://eeas.europa.eu/delegations/albania/eu_albania/political_relations/index_en.htm (vizituar më 30/06/2013).

²⁷ Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Bosnja dhe Hercegovina*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/bosnia-herzegovina/index_en.htm (vizituar më 30/06/2013).

²⁸ Shih fusnotën nr. 26.

²⁹ Shih fusnotën nr 27.

³⁰ Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Serbia*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/serbia/index_en.htm (vizituar më 30/06/2013).

³¹ Po aty.

³² Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Mali i Zi*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-countryinformation/montenegro/index_en.htm (vizituar më 30/06/2013).

³³ Po aty.

³⁴ Shih fusnotën nr 30.

vite. Krahasuar me vendet tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor, rasti i Kosovës ndryshon në shumë aspekte. Kosova është kandidat potencial për anëtarësim në BE.

Edhe pse nuk është i vetmi kandidat potencial nga rajoni, pozita e saj unike dhe rrethanat e jashtëzakonshme kanë shkaktuar vonesa të rëndësishme në procesin e përafrimit me BE-në.

Një ngjarje e rëndësishme që është specifike për Kosovën ndërlidhet me vitin 2005, kur Komisioni Evropian miraton komunikatën për ‘Të ardhmen Evropiane për Kosovën’. Tre vjet më vonë, më 2008, Këshilli miraton Aksionin e Përbashkët që përcakton misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë - EULEX. Sidoqoftë, kohëve të fundit BE-ja ka bërë disa hapa të vegjël në raportet e saj me Kosovën.

Këto më së shumti lidhen me konkluzionet e Këshillit të BE-së, nga 5 dhjetor 2011. E rëndësishme të theksohet është që konkluzionet e Këshillit në një mënyrë kanë hapur mundësinë për dialogun e vizave të Kosovës me Komisionin Evropian.³⁵ Poashtu, konkluzionet e Këshillit kanë hapur mundësinë për marrëveshje të mundshme tregtare me Kosovën, anëtarësimin e Kosovës në Bankën për Rindërtim dhe Zhvillim dhe mundësinë e pjesëmarrjes të Kosovës në programe të BE-së.³⁶ Në janar 2012, Komisioni filloi dialogun për liberalizim të vizave me Kosovën. Disa muaj më vonë, filloi Dialogu i Strukturuar mbi Sundimin e Ligjit, së bashku me lansimin e udhërrëfyesit të liberalizimit të vizave nga Komisioni.

Për më shumë, këto përparime të vogla janë ndjekur me konkluzionet e Këshillit në mars 2012 dhe kanë arritur nivelin më të lartë me *studimin e fizibilitetit* për MSA ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Studimi i fizibilitetit i publikuar në tetor 2012, në të vërtetë është konsideruar hapi i parë konkret për Kosovën në hyrje të rrugës së gjatë të marrëdhënieve kontraktuale dhe serioze me BE-në. Ky studim ka ekzaminuar nëse janë përmbushur kriteret politike, ekonomike dhe ligjore për një Marrëveshje të Stabilizim Asociimit. Raporti shënon se Kosova ‘... në pjesën më të madhe është e gatshme të filloj negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit’.

Megjithatë, Komisioni ka propozuar direktivat negociuese në rast të përmbushjes së prioriteteve në fushën e drejtësisë, administratës publike, mbrojtjes së pakicës dhe tregtisë.³⁷ Kohëve të fundit, në prill të vitit 2013, Komisioni i ka propozuar Këshillit që të vendos autorizimin e hapjes së negociatave për MSA-në ndërmjet BE-së dhe Kosovës.

³⁵ Këshilli i Bashkimit Evropian (2011) *Konkluzionet e Këshillit mbi zgjerimin dhe procesin e stabilizim asociimit*. E disponueshme: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/126577.pdf (vizituar më 30/06/2013).

³⁶ Po aty.

³⁷ Komisioni Evropian (2012) *Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf (vizituar më 30/06/2013).

Por, duke pasur parasysh mos-njohjen e pavarësisë së Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së, pritjet të ketë shumë sfida – kryesisht të lidhura me këtë dimension – gjatë fillimit të negociatave për MSA-në. Ngjashëm, edhe nëse do të kemi konkludim të MSA-së ndërmjet Kosovës dhe BE-së, procesi i ratifikimit në shtetet anëtare të BE-së do të jetë sfidues, veçanërisht tek pesë shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën.

3.1. Nën-përfundimet: Kosova përballë vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor në lidhje me MSA-në

Në përgjithësi, krahasuar me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova është i vetmi vend në rajonin e Ballkanit Perëndimor pa MSA-në dhe me regjim të vizave me BE-në. Me fjalë tjera, Kosova mbetet vendi i fundit në Ballkanin Perëndimor pa marrëdhënie kontraktuale me BE-në (gjë që vazhdon edhe pas periudhës së pavarësisë). Për më shumë, ekzistojnë dallime kyçe ndërmjet Kosovës dhe vendeve tjera të rajonit në Ballkanin Perëndimor.

Në këtë aspekt, Kosova vazhdon të jetë vendi me prani më të madhe të BE-së (krahasuar me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor). Prandaj, duke pasur parasysh këto dy fakte, duket sikur kemi të bëjmë me një lloj kontradikte në vetvete. Gjithashtu, sfida si për Kosovën edhe për BE-në mbetet normalizimi i gjendjes në Veriun e Kosovës dhe raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe vazhdimi i dialogut ndërmjet tyre. Të gjitha këto bëjnë që raportet Kosovë-BE të jenë unike (*sui generis*), dhe në të njëjtën kohë, shumë të komplikuar.

4. Raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së (1999-2013)

Sipas këtij studimi, ekzistojnë dy faza të rëndësishme së veçantë që duhet të analizohen në raportet ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Faza e parë fillon menjëherë pas bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë në vitin 1999 deri në Deklarimin e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Faza e dytë e analizimit të raporteve lidhet me periudhën pas-shpalljes së pavarësisë së Kosovës deri më ditët e sotme (qershor, 2013).

4.1. Raportet BE-Kosovë (1999 -2008)

Kosova është në proces të konsolidimit të sistemit të brendshëm, strukturave dhe institucioneve të qeverisjes. Kosova është duke kaluar në një seri procesesh që janë të rëndësishme për të ardhmen dhe popullin e saj. Këto procese nuk lidhen vetëm me përpilim të duhur dhe funksionim efikas të strukturave të autoritetit dhe kontrollit, por edhe me sistemin e përcaktimit të vlerave ose rezultateve, në veçanti me atë të sistemit të mirëqenies dhe bashkëpunimit rajonal dhe/ose ndërkombëtar, sigurisë dhe stabilitetit. Rritja e vazhdueshme e ndërlikimeve dhe ndërvarësisë ndërmjet popujve dhe problemeve kërkon veprime të veçanta dhe vëmendje për çështje që tejkalojnë kufijtë kombëtar. Përkrahja e aktorëve ndërkombëtarë (në veçanti e BE-së) është e rëndësishme së veçantë.

Që nga viti 1999, raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së kanë qenë në partneritet të vazhdueshëm karakterizuar nga një qasje konstruktive dhe vendosmëri të BE-së për të ndihmuar Kosovën në rrugën e saj Evropiane. Në këtë aspekt, që nga viti 1999, BE-ja ka luajtur dy role kryesore. Njëra lidhet me mbështetjen financiare – p.sh., investime të vazhdueshme në përkrahje të zhvillimit institucional dhe kapaciteteve të saj dhe miratimit të parimeve dhe rregullave të BE-së.³⁸ Roli tjetër i BE-së në Kosovë lidhet me përkushtimin e BE-së për ruajtjen e stabilitetit, paqes dhe perspektivës Evropiane për Ballkanin Perëndimor. Me qëllim të zhvillimit të kësaj perspektive, BE-ja ka ofruar ndërmjetësim politikë duke sjellë praktika dhe shembuj të mirë në Kosovë.³⁹

Me qëllim të arritjes së këtyre qëllimeve, BE-ja ka pasur një prani të madhe në Kosovë. Me gjithë praninë e BE-së (e njohur si Shtylla IV) brenda UNMIK-ut, ajo ka vazhduar të rrisë praninë e saj në terren në Kosovë.

Në këtë aspekt, agjencia e parë e BE-së që ishte themeluar në Kosovën e pas-luftës pas Shtyllës së BE-së brenda UNMIK-ut, ishte Agjencioni Evropian për Rindërtim (mëpastaj: AER). AER-i në fillimet e vitit 2000 ka vazhduar detyrën e Grupit Punues të Komisionit Evropian për Rindërtim të Kosovës (një trup i përkohshëm për ndihmë emergjente i themeluar në verë të vitit 2000), pas intervenimit të NATO-s.⁴⁰ Kjo ishte pasuar me themelim të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (MMBE) në mes të vitit 2000, duke zëvendësuar Misionin Monitorues të Komunitetit Evropian (MMKE) e cila kishte operuar në Ballkanin Perëndimor që nga qershori i vitit 1991. Në prill të vitit 2004, Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë (PL PPJS), Javier Solana, emëroi një Përfaqësues Personal në Kosovë dhe një zyrë e PPJS-së ishte themeluar në Prishtinë (e quajtur ‘Zyra e Solanës’). Kjo zyrë ka qenë një ndërmjetësues i fuqishëm ndërmjet forcave politike kryesore në Kosovë dhe ka krijuar lidhje të mira me institucionet e Kosovës. Në këtë kontekst, në shtator të vitit 2004 është themeluar një Zyrë e vogël Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (më pastaj: ZNKE) në Prishtinë. Detyrat e ZNKE-së kanë qenë të ngjashme me atë të Delegacioneve të Komisionit nëpër vende tjera, por me disa kufizime për shkak të statusit të pazgjidhur politik të Kosovës deri më 2008 dhe për

³⁸ Intervistë 2: Zyrtar i Lartë, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (Prishtinë, 26/02/2013); Intervistë 3: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 28/02/2013); Intervistë 4: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 5: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 7: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 05/03/2013); Intervistë 11: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 11/03/2013); Intervistë 13: Zyrtar i Lartë, Oda Ekonomike e Kosovës (Prishtinë, 15/03/2013); Intervistë 16: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 25/03/2013); Intervistë 19: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 22/04/2013); Intervistë 20: Zyrtar i Lartë, Ministria e Integritimit Evropian (Prishtinë, 24/04/2013); Intervistë 23: Ligjërues i të Drejtës Evropiane dhe Ndërkombëtare, Universiteti Prishtinës (Prishtinë, 29/04/2013); Intervistë 24: Kërkues në Çështje Evropiane (Prishtinë, 30/04/2013).

³⁹ Intervistë 6: Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 8: Ambasador i Italisë në Kosovë (Prishtinë, 06/03/2013); Intervistë 16: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 25/03/2013); Intervistë 18: Hulumtues mbi Integritimin në BE (Prishtinë, 10/04/2013); Intervistë 19: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 22/04/2013); Intervistë 22: Aktivisti i Shoqërisë Civile (Prishtinë, 26/04/2013).

⁴⁰ Agjencia Evropiane për Rindërtim (2006) *Raporti Tremujor i Aktivitetit*. E disponueshme: www.AER.europa.eu/publications/main/AER-ActivityReports-Quarterly-ApriltoJune2006.htm (vizituar më 30/06/2013).

shkak të AER-it që deri atëherë ka udhëhequr të gjitha projektet e asistencës në Kosovë. Si pasojë, puna e ZNKE-së deri atëherë më shumë është drejtuar në përkrahjen e ngritjes së kapacitetit të institucioneve të Kosovës, si dhe në zbatim të instrumenteve politike të ndryshme në Kosovë, duke përfshirë Mekanizmin Përcjellës të Procesit të Stabilizim Asociimit (MPS), dhe më vonë Planin e Partneritetit Evropian të Kosovës (PPE).⁴¹ Roli i ZNKE-së është ndryshuar në periudhën e pas-pavarësisë.

Për më shumë, në nëntor të vitit 2006, Torbjorn Sohlstrom është emëruar përgjegjës për themelimin e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN) – institucion që ka pasuar rolin e UNMIK-ut (edhe pse në shkallë më të vogël) pas zgjidhjes së statusit të Kosovës. Për të ndihmuar këtë proces, nga mesi i vitit 2006 një Ekip Planifikues i Bashkimit Evropian (EUPT) është themeluar në Prishtinë.

Shkurtimisht, përveç Shtyllës së BE-së brenda UNMIK-ut, agjencionet e BE-së që kanë vepruar në Kosovë nga viti 2000-2008 janë:

1. Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER);
2. Misioni Monitorues i Bashkimit Evropian (MMBE);
3. Përfaqësues Personal i Përfaqësuesit të Lartë të BE-së, PPJS;
4. Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE);
5. Ekipi Planifikues i BE-së për Misionin e EULEX-it (EUPT); dhe
6. Zyrat ndërlidhëse të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian në Prishtinë të cilat përfaqësojnë Presidencën e BE-së.

Në anën tjetër, përkundër pranisë së saj në terren dhe mbështetjes financiare (mekanizmit të karrotës), BE-ja në zbatim të politikave të saj, poashtu ka zbatuar mjetin e (shkopit) në veçanti nëpërmjet raporteve të saj të progresit. Në këtë aspekt, raporti i parë i Komisionit Evropian për progresin e Kosovës, është publikuar në vitin 2005 (para këtij viti, raporti i progresit të Kosovës është publikuar së bashku me Serbinë dhe Malin e Zi). Ky raport i progresit ka përmbledhur çështje lidhur me standardet Evropiane, zhvillimet demokratike, politika të ndryshme sektoriale dhe aspekte tjera lidhur me të. Sigurisht, ky raport merret me çështje të cilat adresohen edhe në raportet tjera të progresit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Për shembull, sa i përket standardeve Evropiane ky raport përmend që Kosova ka filluar zbatimin e Tarifës së Integruar për Kosovën (TARIK). TARIK bazohet në sistemin tarifor të doganave ndërkombëtare dhe

⁴¹ Komisioni Evropian (2005) *Një e ardhme Evropiane për Kosovën*. COM 156 final.

Evropiane.⁴² Sidoqoftë, raporti thekson nevojën për vazhdimësi të reformave në administrim të tatimeve, me qëllim të zgjerimit të kapacitetit mbledhës dhe kontrollues. Në këtë aspekt, forcimi i luftës ndaj korrupsionit dhe nxitja për të zbatuar pa diskriminim ligjin e tatimeve janë sfida me të cilat Kosova duhet të merret.⁴³

Sa i përket politikave sektoriale, raporti vlerëson që Kosova ka shënuar progres të vogël në fushën e industrisë dhe NVM-së. Megjithatë, sektori i NVM-së vazhdon të ballafaqohet me mjedis të dobët ligjor dhe rregullues, infrastrukturë dhe shkathtësi të dobëta udhëheqëse.⁴⁴

Sa i përket zhvillimeve demokratike, Raporti i Progresit për Kosovë (2005) tërheq vërejtjen në defiçencat demokratike dhe mënyrën e funksionimit jo-efikas të institucioneve dhe thekson nevojën për përkushtim më të madh nga elita politike e nivelit lokal dhe qendror, me qëllim të garantimit të paanshmërisë në ushtrim të funksioneve të tyre publike.⁴⁵ Derisa progres është shënuar në lirinë e shprehjes, sundimi i ligjit dhe kapaciteti administrativ vlerësohen me zhvillim shumë të dobët ku duhet të ndërmerren hapa për përmirësim të mëtejshëm.⁴⁶

Një diskurs i ngjashëm sa i përket progresit në Kosovë është shënuar edhe në Raportet e Progresit të Kosovës në vitin 2006 dhe 2007. Për shembull, sa i përket standardeve Evropiane, në Raportin e Progresit të Kosovës, në vitin 2006 progres i rëndësishëm është shënuar brenda shërbimit doganor të UNMIK-ut. Për më shumë, është vërejtur shumë pak ose aspak progres në fusha tjera të tregut të brendshëm.⁴⁷ Ndërsa sa i përket *politikave sektoriale* progres është vërejtur në politikat e industrisë dhe NVM-së.⁴⁸ Poashtu, procesi i regjistrimit të bizneseve është thjeshtësuar dhe progres është shënuar në lidhje me çështjet tatimore.⁴⁹ Raporti i Progresit 2008 thekson se progres është bërë në zhvillimin e strukturës horizontale të *acquis* që ka të bëjë me lëvizjen e lirë të mallrave dhe ngritjes së kapacitetit administrativ për të qenë në linjë me standarde Evropiane.⁵⁰ Disa sfida të reja poashtu janë shënuar në raportin e progresit të vitit 2008. Kjo lidhet kryesisht me dy pika kufitare në Veri të Kosovës të cilat janë shkatërruar pas

⁴² Komisioni Evropian (2005) *Raporti i Progresit të Kosovës * 2005*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1423_final_progress_report_ks_en.pdf (vizituar më 30/06/2013).

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Komisioni Evropian (2006) *Raporti i Progresit të Kosovës * 2006*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2006/nov/ks_sec_1386_en.pdf (vizituar më 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2007). *Raporti i Progresit të Kosovës * 2007*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/kosovo_progress_reports_en.pdf (vizituar më 30/06/2013).

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Komisioni Evropian (2008) *Raporti i Progresit të Kosovës * 2008*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/keydocuments/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf (vizituar më 30/06/2013).

pavarësisë së Kosovës. Si në vitin 2006 dhe 2007, ashtu edhe në vitin 2008, progres i limituar ose aspak progres nuk është shënuar në fusha tjera të tregut të brendshëm, me përjashtim në fushën e prokurimit publik dhe hulumtimit ku është shënuar pak progres.⁵¹

4.2. Nën-përfundimet: Raportet BE-Kosovë (1999-2008)

Që nga viti 1999, raportet e Kosovës me BE-në kanë shënuar rritje të ndjeshme dhe partneritet, që karakterizohet me qasje konstruktive dhe vendosmëri të BE-së për të ndihmuar Kosovën në rrugën e saj Evropiane. Në këtë aspekt, me praninë e madhe të saj në Kosovë, pastaj me mjetet e ‘shkopit dhe karrotës’, BE-ja ka kryer dy role kryesore në vitet 1999-2008. E para lidhet me mbështetjen financiare për Kosovën dhe e dyta lidhet me përkushtimin e BE-së në nxitje të stabilitetit, paqes dhe perspektivës Evropiane për Kosovë dhe më gjerë në Ballkanin Perëndimor.

4.3. Raportet BE-Kosovë (2008-2013)

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, në shkurt të vitit 2008, paraqet një fazë të re në raportet Kosovë-BE. Një ditë pas deklarimit të pavarësisë, Këshilli i BE-së për Çështje të Përgjithshme mban shënim mbi këtë deklaratë dhe konfirmon perspektivën e Kosovës në BE. Kjo ngjarje dhe ditë lidhet edhe me fillimin e ri-konfigurimit të rolit të BE-së në Kosovë.⁵²

Në vitin 2009, raportet BE-Kosovë, poashtu kanë shënuar progres por kanë hasur edhe në sfida më të mëdha. Pasqyra e raporteve BE-Kosovë në vitin 2009 vijon si më poshtë. Raporti i Progresit të Kosovës 2009, thekson faktin që Kosova është anëtarësuar në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.⁵³ Për shembull, si sfida në ekonominë e Kosovës identifikohet prania e madhe e sektorit jo-formal dhe mangësitë në kornizën ligjore.⁵⁴ Për më shumë, në lidhje me administratën publike në Kosovë, raporti thekson faktin që ende mbetet e dobët dhe ekziston nevoja për reforma në administratën publike, me qëllim të forcimit të kapaciteteve, paanshmërisë dhe profesionalizmit.⁵⁵ Gjithashtu, raporti identifikon nevojën për përmirësim të mjedisit biznesor dhe evidentimit të rezultateve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.⁵⁶ Si dhe, raporti thekson nevojën për përpjekje të mëtejme në mbrojtje të pakicave dhe përkushtim më të madh për dialog dhe pajtim ndërmjet komuniteteve në Kosovë.⁵⁷

⁵¹ Po aty.

⁵² Intervistë 8: Ambasador i Italisë në Kosovë (Prishtinë, 06/03/2013); Intervistë 15: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 22/03/2013).

⁵³ Komisioni Evropian (2009) *Raporti i Progresit të Kosovës* 2009*. E disponueshme:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf (vizituar më 30/06/2013).

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Po aty.

Me qëllim të shënimit të një etape të re në dialogun BE-Kosovë, në vitin 2009 Komisioni propozon forcimin dhe zgjerimin e pjesëmarrjes së Kosovës në PAS nëpërmjet krijimit të një mekanizmi të një dialogu të qëndrueshëm për PAS.⁵⁸

Në anën tjetër, sfidat e theksuara në raportin e progresit 2009 vazhduan të mbeten të ngjashme edhe në vitin 2010 dhe 2011, pa ndonjë arritje të rëndësishme në raportet BE-Kosovë gjatë kësaj periudhe.

Në vitin 2012, lansimi dhe prezantimi i udhërrëfyesit për liberalizim të vizave dhe publikimi i studimit të fizibilitetit përbëjnë zhvillimet kryesore në raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së. E rëndësishme së veçantë është studimi i fizibilitetit (tetor 2012) i publikuar nga institucionet e BE-së, që thekson se nuk ka pengesa ligjore për BE-në për konkludim të MSA-së me Kosovën.

Megjithatë, studimi i fizibilitetit për MSA-në identifikon disa sfida për Kosovën, të cilat janë pjesë e përmbushjes së obligimeve për fillim të negociatave të MSA-së. Ndër obligimet e para lidhet me përmirësimin e efikasitetit, përgjegjësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit.⁵⁹ Pastaj, obligimi tjetër lidhet me reformën në administratën publike. Më konkretisht, Kosova duhet të fillojë reforma që sigurojnë administratë publike të qëndrueshme, duke përfshirë financimin e nevojshëm dhe stafin mbështetës.⁶⁰ Një sërë kriteresh ose obligimesh tjera për Kosovën lidhen me promovimin e shoqërisë shumë-etnike, me qëllim të krijimit të kushteve për pakicat dhe në veçanti për pakicën Serbe që të ndjehet pjesë e Kosovës dhe në këtë aspekt të lehtësohet kthimi i personave të zhvendosur.⁶¹

Sa i përket tregtisë që është një nga aspektet më të rëndësishme në kontekstin e MSA-së, nga Kosova kërkohet implementimi i vendimit të qeverisë në ristrukturim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.⁶² Poashtu, kërkohet edhe që Kosova të krijoj mekanizma relevantë që do të koordinonin negociatat.⁶³ Si rezultat i përmbushjes së kriterëve nga autoritetet Kosovare, në prill të vitit 2013, Komisioni Evropian i propozoi Këshillit që të autorizoj hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Kjo është shumë e rëndësishme pasi që vendos themelet për marrëdhënie kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së.⁶⁴ Në këtë kontekst, duhet të theksohet fakti që raportet aktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Shih fusnotën nr. 37.

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Po aty.

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Intervistë 1: Zyrtar i EUSR-së (Prishtinë, 22/02/2013); Intervistë 8: Ambasador i Italisë në Kosovë (Prishtinë, 06/03/2013); Intervistë 9: Zyrtar i Lartë Politik, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë / Përfaqësuesi Special i BE-së (Prishtinë, 08/03/2013); Intervistë 10: Zyrtar Politik, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë / Përfaqësuesi Special i BE-së (Prishtinë, 08/03/2013); Intervistë 11: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 11/03/2013); Intervistë 12: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 13/03/2013); Intervistë 16: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 25/03/2013).

karakterizohen si dinamike dhe në përgjithësi brenda kornizës së proceseve integruese Evropiane me vendet tjera të Ballkanit. BE-ja vazhdon të jetë në funksion të nxitjes së progresit në rajon. Ajo vazhdon të mbështet Kosovën në të gjitha fushat, në veçanti në sundimin e ligjit.⁶⁵

Sidoqoftë, në rrugën e integritimeve Evropiane, raportet e Kosovës me BE-në përcaktohen gjithashtu nga mos-njohja e pavarësisë së Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së. Mos-njohja nga pesë shtete anëtare të BE-së sjell pasoja të ndryshme, veçanërisht në aspektin politikë. BE-ja has në vështirësi të veçanta në arritje të konsensusit dhe vendimeve me pesë shtete anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën sa i përket proceseve integruese të Kosovës, kështu që shkaktohen vonesa në proceset integruese. Për më shumë, kjo pengon jo vetëm materializimin e perspektivës Evropiane të Kosovës, por sfidon edhe institucionet e BE-së në vetvete.⁶⁶

Një aspekt tjetër që ndikon në raportet Kosovë-BE është dialogu i vazhdueshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përkushtimi i Kosovës dhe qasja konstruktive në dialog me Serbinë duket të jetë parakusht për forcimin e rrugës së saj në integrimin Evropian.⁶⁷

Disa sfida tjera në lidhje me raportet BE-Kosovë janë:

Dështimet e institucioneve të Kosovës në procesin e integritimit Evropian nuk duhet të identifikojnë si fajtor BE-në, por autoritetet e Kosovës duhet të përqendrohen në zgjidhje të këtyre çështjeve.

Për më shumë, Kosova duhet të krijoj një proces të ndershëm politik duke zvogëluar hendekun mes sjelljeve verbale dhe veprimeve të tyre.⁶⁸ Në lidhje me këtë, në masë të madhe raportet BE-Kosovë varen nga përmbushja dhe implementimi i standardeve të BE-së. Në këtë aspekt, sundimi i ligjit është një prej standardeve më të rëndësishme që duhet të përmirësohet në Kosovë. Për shembull, zbatimi i ligjit në Veri të Kosovës dhe lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit do të jenë faktor të rëndësishëm në përcaktim të këtyre raporteve.⁶⁹ Poashtu, sfidë tjetër në raportet BE-Kosovë brendësimi i mëtejshëm i rregullave dhe praktikave të BE-së nga tërë shoqëria.⁷⁰

4.4. Nën-përfundimet: Raportet BE-Kosovë (2008-2013)

⁶⁵ Intervistë 16: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 25/03/2013).

⁶⁶ Intervistë 17: Zyrtar i Lartë, Ministria e Punëve të Jashtme (Prishtinë, 29/03/2013).

⁶⁷ Intervistë 6: Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 12: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 13/03/2013); Intervistë 14: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 21/03/2013).

⁶⁸ Intervistë 5: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 15: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 22/03/2013); Takimi i Tryezës së rrumbullakët "Identifikimi i sfidave, mundësive dhe strategjive për negociatën të mundshme dhe ratifikimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian". Organizuar nga RIDEA (14. 05. 2013).

⁶⁹ Intervistë 6: Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës (Prishtinë, 01/03/2013).

⁷⁰ Intervistë 2: Zyrtar i Lartë, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (Prishtinë, 26/02/2013); Intervistë 11: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 11/03/2013).

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, në shkurt të vitit 2008, ka shënuar një fillim të ri në raportet Kosovë-BE, veçanërisht në lidhje me procesin e ri-konfigurimit të pranisë së BE-së në Kosovë. Në vitin 2009, raportet BE-Kosovë kanë shënuar progres të mëtejshëm, me ç'rast Komisioni propozoi fuqizimin dhe zgjerimin e pjesëmarrjes së Kosovës në PAS nëpërmjet krijimit të një mekanizmi të një dialogu të qëndrueshëm për PAS. Në vitin 2010 dhe 2011 nuk është shënuar ndonjë moment i veçantë ose i rëndësishëm në raportet BE-Kosovë.

Në anën tjetër, progres është shënuar në raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së në vitin 2012. Në veçanti, ky progres lidhet me lansimin dhe prezantimin e udhërrëfyesit për liberalizim të vizave dhe publikimin e studimit të fizibilitetit nga BE-ja. Raporti BE-Kosovë është fuqizuar ose konsoliduar edhe më shumë në prill të vitit 2013, kur Komisioni Evropian i propozoi Këshillit që të vendos për autorizimin e hapjes së negociatave të MSA-së ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Në fundmi, raporti ndërmjet Kosovës dhe BE-së kulmoi me vendimin e Këshillit të BE-së (qershor, 2013) që të fillon negociatat me Kosovën për MSA-në. Si rrjedhojë, pjesa tjetër e këtij studimi paraqet më hollësisht sfidat e Kosovës që mund të hasen gjatë fazës negociuese të MSA-së, të cilat do të pasohen nga pjesa lidhur me sfidat që mund të hasen në procesin e mundshëm ratifikues të MSA-së nga BE-ja.

5. Sfidat dhe mundësitë e Kosovës gjatë fazës negociuese të MSA-së

Gjatë fazës negociuese të MSA-së pritet që Kosova të ballafaqohet me sfida të shumta. Ky studim identifikon dy kategori të sfidave me të cilat mund të ballafaqohet Kosova gjatë fazës negociuese të MSA-së me BE-në: *sfida të përgjithshme dhe specifike/unike*. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet që këto sfida (të përgjithshme dhe specifike), në të njëjtën kohë, paraqesin mundësi që Kosova të përmirëson qeverisjen dhe cilësinë e jetës së qytetarëve të saj. Ekzistojnë disa *sfida të përgjithshme* për Kosovën gjatë fazës negociuese të MSA-së. Nëse bëjmë një renditje, mund të thuhet që *sfidat e përgjithshme* lidhen me kapacitetin e Kosovës për të negociuar MSA-në, sfidat lidhur me sundimin e ligjit, funksionimin e ekonomisë së tregut etj. Për më tepër, në rastin e Kosovës ky studim ka identifikuar edhe dy *sfida specifike ose unike* (krahasuar me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor). Këto *sfida specifike ose unike* lidhen me mos-njohjen e shtetësisë së Kosovës nga pesë vende anëtare të BE-së dhe mungesën e njohjes dhe dialogut të vazhdueshëm me Serbinë. Pjesët vijuese paraqesin më hollësisht këto çështje.

5.1. Sfidat e përgjithshme

Para se gjithash, sfida në vete ishte vendimi i BE-së në lidhje me fillimin e negociatave me Kosovën për MSA-në. Që nga vendimi pozitiv i Këshillit të BE-së (28 qershor 2013), pritet që negociatat mund të fillojnë në shtator të vitit 2013.⁷¹

⁷¹ Intervistë 6: Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 14: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 21/03/2013); Intervistë 17: Zyrtar i Lartë, Ministria e Punëve të Jashtme (Prishtinë, 29/03/2013).

Sfida tjetër e përgjithshme lidhet me *kapacitetin e Kosovës* për të marrë pjesë në procesin negociues me BE-në. Sfidat lidhur me kapacitetet dhe reformën në administratë publike do të paraqiten paralelisht, ndërsa faza e negociatave për MSA-në paraqet një mundësi unike në këtë aspekt. Me qëllim të plotësimit të nevojave të negocimit për MSA-në me BE-në, Qeveria e Kosovës duhet të përfshijë juristë, ekspertë tjerë dhe teknokrat (vendor dhe ndërkombëtar) që do të jenë të aftë të adresojnë dhe ndërmarrin reformat e nevojshme. Staf i ekzistues duhet t'iu nënshtrohet trajnimeve të ndryshme me qëllim të përmirësimit të shkathtësive të tyre dhe të përmirësohen profesionalisht. Për më shumë, forcimi i nivelit menaxherial, de-politizimi i administratës publike dhe adresimi i korrupsionit në administratë publike do të jenë sfida të mëdha me të cilat mund të ballafaqohet Kosova gjatë fazës negociuese (dhe jo të vetme) të MSA-së.⁷² Reformat në administratën publike ishin sfidë edhe për vendet tjera të Ballkanit Perëndimor gjatë PAS. Për shembull, në rastin e Shqipërisë, raporti i progresit (2005) si brengë thekson aftësinë e administratës publike për të zbatuar MSA-në.⁷³ Poashtu, raporti i progresit të KE-së për Malin e Zi (2006) thekson që sfida kryesore e Malit të Zi lidhur me MSA-në mbetet përmirësimi i kapacitetit administrativ me qëllim të garantimit të zbatimit të marrëveshjes.⁷⁴

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet që ky studim ka gjetur se Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë disa masa parandaluese. Ka krijuar strukturën negociuese dhe ekipin negociues për MSA-në.⁷⁵ Poashtu, duket se Ministria e Integritimit Evropian ka krijuar një plan veprimi dhe zyrtarët e saj janë duke udhëtuar në vendet fqinje me qëllim të marrjes së përvojave mbi këtë proces.⁷⁶

Sundimi i ligjit është sfidë tjetër brenda kategorisë së *sfidave të përgjithshme* me të cilën Kosova duhet të merret gjatë dhe pas fazës negociuese të MSA-së. Reforma të mëdha duhet të ndërmerren në këtë sektor. Në veçanti, duhet të merret më konkretisht me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Arritja e rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është e rëndësishme së veçantë për rrugën e Kosovës në BE. Për më tepër, Kosova duhet të zvogëloj boshllëkun ndërmjet ligjeve të miratuara në letër dhe atyre të

⁷² Intervistë 2: Zyrtar i Lartë, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (Prishtinë, 26/02/2013); Intervistë 15: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 22/03/2013).

⁷³ Komisioni Evropian (2005) *Raporti i Progresit të Shqipërisë 2005*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1421_final_progress_report_al_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

⁷⁴ Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2006) *Raporti i Progresit të Malit të Zi 2006*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2006/nov/mn_sec_1388_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

⁷⁵ Takimi i Tryezës së rrumbullakët "Identifikimi i sfidave, mundësive dhe strategjive për negociatën e mundshme dhe ratifikimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian". Organizuar nga RIDEA (14. 05. 2013)..

⁷⁶ Intervistë 9: Zyrtar i Lartë Politik, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë / Përfaqësuesi Special i BE-së (Prishtinë, 08/03/2013); Intervistë 10: Zyrtar Politik, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë / Përfaqësuesi Special i BE-së (Prishtinë, 08/03/2013).

implementuara në praktikë. Duhet të siguroj pavarësinë e gjyqësorit dhe shmang ndikimin politikë në këtë sektor.

Për më shumë, Kosova duhet të merr masa për zvogëlimin e rasteve të mbetura në sektorin e gjyqësorit. Poashtu, duke u bazuar në përvojat e Kroacisë dhe njësive tjera federale të ish-Jugosllavisë, ballafaqimi me krimet e luftës do të jetë një çështje tjetër me të cilën Kosova duhet të merret.⁷⁷ Për ta ilustruar këtë, raporti i progresit të KE-së (2007) për B&H thekson që para nënshkrimit të MSA-së, ajo duhet të vërtetohet bashkëpunimin e plotë me GJNKJ.⁷⁸ Veprime të ngjashme gjenden edhe në raportin e progresit të KE-së (2007) për Serbinë ku bashkëpunimi i plotë me GJNKJ është kusht i domosdoshëm para nënshkrimit të MSA-së⁷⁹. Në kontekstin e Kosovës, bashkëpunimi me EULEX-in në lidhje me krime të luftës ose aspekte tjera mund të paraqitet si kusht i domosdoshëm për progres të mëtejshëm në fazën negociuese të MSA-së ose edhe në fazën e mëvonshme të ratifikimit. Ngjashëm, Kosova duhet të forcoj dhe përmirësoj më tej kapacitetet e saj dhe legjislacionin lidhur me sektorin e gjyqësorit.

Një *sfidë tjetër e përgjithshme* të cilën Kosova duhet të adresoj gjatë dhe pas fazës negociuese të MSA-së ka të bëjë me reformat në *funksionimin e ekonomisë së tregut*. Më konkretisht, kornizat e nevojshme ligjore të tregut sikur siguria e ushqimit, kontrolli sanitar duhet të përcaktohen. Gjithashtu, gjatë fazës negociuese të MSA-së, Kosova duhet të zvogëloj informalitetin dhe përmirëson mjedisin biznesor dhe përkrah më shumë sektorin privat.⁸⁰

Prova e zbatimit të *standardeve Evropiane* është *sfida tjetër e përgjithshme* për Kosovën gjatë dhe pas fazës negociuese të MSA-së. Veçanërisht, në lidhje me këtë sfidë e rëndësishme së veçantë është progresi në sektorin e doganave, lëvizjes së lirë të mallrave, dhe çështje tjera lidhur me tregun dhe tregtinë, me qëllim të përshtatjes me standarde Evropiane. Është e rëndësishme që Kosova të tregoj përkushtim serioz në implementim të standardeve të BE-së.⁸¹ Për shembull, në rastin e Shqipërisë për të rekomanduar konkludimin e marrëveshjes, Shqipërisë iu është dashur

⁷⁷ Intervistë 3: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 28/02/2013); Intervistë 7: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 05/03/2013); Intervistë 11: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 11/03/2013); Intervistë 14: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 21/03/2013).

⁷⁸ Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2007) *Raporti i Progresit të Bosnjës dhe Hercegovinës 2007*. E disponueshme:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/bosnia_herzegovina_progress_reports_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

⁷⁹ Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2007) *Raporti i Progresit të Serbisë 2007*. E disponueshme:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/serbia_progress_reports_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

⁸⁰ Intervistë 5: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 13: Zyrtar i Lartë, Oda Ekonomike e Kosovës (Prishtinë, 15/03/2013).

⁸¹ Intervistë 6: Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës (Prishtinë, 01/03/2013); Zyrtar Politik – EUSR. Takimi i Tryezës së rumbullakët "Identifikimi i sfidave, mundësive dhe strategjive për negociata të mundshme dhe ratifikimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian". Organizuar nga RIDEA (14. 05. 2013).

garantimi i mbajtjes së drejtë të zgjedhjeve parlamentare në vitin 2005 në pajtim me standardet Evropiane.⁸² Në këtë aspekt as Kosova nuk do të jetë përjashtim.

Gjatë fazës negociuese të MSA-së, sfidë tjetër do të jetë **përfshirja e akterëve të rëndësishëm** brenda procesit. Me fjalë të tjera, duhet të bëhen diskutime në parlamentin e Kosovës dhe institucione tjera relevante për çështje të negociuara. Për më shumë, gjatë këtij procesi Qeveria e Kosovës duhet të siguroj përfshirjen e partive të opozitës, shoqërisë civile, botës akademike dhe partnerëve tjerë të rëndësishëm brenda këtij procesi. Ky proces do të krijoj kushte për një proces të suksesshëm negociues të MSA-së. Në këtë aspekt, Kosova duhet të bisedoj me fqinjët e saj, me qëllim të marrjes së përvojave, dhe përgatitjes më të mirë në këtë proces.⁸³

5.2. Sfidat Specifike

Siç është cekur më sipër, krahasuar me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, në rastin e Kosovës ekzistojnë dy sfida shtesë specifike/unike në lidhje me fazën negociuese të MSA-së.

E para nga këto *sfida specifike* ka të bëjë me mos-njohjen e pavarësisë së Kosovës nga **pesë shtete anëtare të BE-së** (Qipro, Greqi, Rumani, Sllovakia dhe Spanjë). BE-ja është unike sa i përket hyrjes në procesin e MSA-së me Kosovën. Sidoqoftë, Kosova është vonuar në procesin e integritit të BE-së për shkak të mungesës së pajtimit brenda BE-së, dhe në veçanti me pesë shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën. Probleme tjera të veçanta mund të paraqiten në fazat e mëvonshme kur MSA-ja duhet të ratifikohet ose në rastin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet anëtare të BE-së.⁸⁴ Në rastin e Kosovës, duket sikur BE-ja çdoherë duhet të gjej diçka të re për të arritur marrëveshje me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën.⁸⁵

Sfida e dytë specifike që lidhet me fazën gjatë dhe pas negociuese të MSA-së për Kosovën janë **raportet e përgjithshme me Serbinë**. Në përgjithësi, progresi i Kosovës në proceset e integritimeve Evropiane do të varet nga situata e përgjithshme në vendet e Ballkanit, por në veçanti lidhur me raportet e saj me Serbinë. Marrëveshja e fundit për Veriun e Kosovës krijon një perspektivë më të mirë në këtë aspekt, por zbatimi i saj dhe çështje tjera të hapura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (p.sh., njohja reciproke e shtetësisë) vazhdojnë të mbeten sfidë. Duket sikur, duhet të vazhdohet normalizimi gradual i raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me qëllim të forcimit të proceseve integruuese Evropiane.⁸⁶

⁸² Shih fusnotën nr. 73.

⁸³ Intervistë 1: Zyrtar, EUSR (Prishtinë, 22/02/2013); Intervistë 2: Zyrtar i Lartë, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (Prishtinë, 26/02/2013).

⁸⁴ Intervistë 8: Ambasador i Italisë në Kosovë (Prishtinë, 06/03/2013); Intervistë 15: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 22/03/2013); Intervistë 17: Zyrtar i Lartë, Ministria e Punëve të Jashtme (Prishtinë, 29/03/2013).

⁸⁵ Po aty.

⁸⁶ Intervistë 1: Zyrtar, EUSR (Prishtinë, 22/02/2013); Intervistë 8: Ambasador i Italisë në Kosovë (Prishtinë, 06/03/2013).

5.3. Nën-përfundimet: Sfidat dhe mundësitë e Kosovës gjatë fazës negociuese të MSA-së

Kjo pjesë identifikoi dy kategori të sfidave me të cilat mund të ballafaqohet gjatë fazës negociuese të MSA-së me BE-në: sfidat e përgjithshme dhe specifike/unike. *Sfidat e përgjithshme* për Kosovën gjatë fazës negociuese të MSA-së përfshijnë çështje të ndryshme nga sundimi i ligjit tek funksionimi i ekonomisë së tregut dhe reforma në administratën publike. Në anën tjetër, *sfidat specifike ose unike* në rastin e Kosovës lidhen me mos-njohjen e shtetësisë së Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së dhe mungesa e njohjes dhe dialogut të vazhdueshëm me Serbinë.

Sidoqoftë, të dy sfidat dhe në veçanti ato të *përgjithshme* paraqesin mundësi për Kosovën që të përmirësoj qeverisjen dhe cilësinë e jetës së qytetarëve të saj. Me fjalë tjera, procesi negociues për MSA-në është mundësi unike për Kosovën që të thelloj stabilitetin e brendshëm dhe forcoj institucionet e saj. Gjatë këtij procesi, BE-ja do të zgjeron përkrahjen financiare dhe teknike për Kosovën nëpërmjet ofrimit të më shumë ekspertëve dhe ndihmës më të madhe për ndërtim të kapaciteteve institucionale të Kosovës. Nëpërmjet negociatave të MSA-së, legjislacioni i Kosovës do të përafrohet me legjislacionin e BE-së gjë që do ta vendos Kosovën drejt qëllimeve të integritimit në BE.⁸⁷ Poashtu, në këtë proces, Kosova duhet të tregoj vullnet pozitiv.

Është mundësi për Kosovën që të tërheq investimet e jashtme dhe të përmirësoj situatën e përgjithshme në ekonomi.⁸⁸ Prandaj, nëpërmjet reformave pozitive në institucione, legjislacion dhe ekonomi, në përgjithësi do të paraqitet edhe mundësia për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Sigurisht, faza negociuese e MSA-së nuk do të ndryshoj në tërësi situatën ekonomike dhe politike në Kosovë. Por, nëse merret seriozisht nga institucionet e Kosovës – mund të shërbej si një hap i vogël dhe/ose i parë në këtë rrugë ose drejtim.

6. Sfidat dhe mundësitë e Kosovës gjatë fazës eventuale të ratifikimit për MSA-në

Ngjashëm me fazën negociuese të MSA-së, gjatë fazës eventuale të ratifikimit të MSA-së, pritet që Kosova të ballafaqohet me sfida të shumta. Nëse rrugëtimi i Kosovës gjatë procesit të ratifikimit do të jetë i njëjtë si me ato të vendeve tjera të Ballkanit (p.sh., nëse çdo shtet anëtar do

⁸⁷ Intervistë 15: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 22/03/2013).

⁸⁸ Intervistë 7: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 05/03/2013); Intervistë 11: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 11/03/2013); Intervistë 12: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 13/03/2013); Takimi i Tryezës së rumbullakët "Identifikimi i sfidave, mundësive dhe strategjive për negociatën e mundshme dhe ratifikimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian". Organizuar nga RIDEA (14/05/2013).

të duhet ta ratifikon MSA-në me Kosovën⁸⁹), pritet që Kosova të ballafaqohet me sfida të mëdha (në veçanti me disa nga shtetet që nuk e kanë njohur). Me fjalë tjera, përveç ballafaqimit me sfida të përgjithshme/standarde sikurse nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (në lidhje me zbatimin e MSA-së dhe reformave në sektorë të ndryshëm), Kosova poashtu do të ballafaqohet me sfida specifike/unike. Sikurse në rastin e fazës negociuese të MSA-së, këto *sfida specifike ose unike* lidhen me mosnjohjen e shtetësisë së Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së dhe mungesën e njohjes dhe vazhdimin e dialogut të mundshëm me Serbinë. Pjesët vijuese diskutojnë më hollësisht të gjitha këto çështje.

6.1. Sfidat e Përgjithshme

Gjatë fazës së ratifikimit të MSA-së nga BE-ja, Kosova do të ballafaqohet me një *sfidë vendimtare të përgjithshme* që lidhet me zbatimin e MP/MSA-së. Në përgjithësi pritet që shumë nga vendet anëtare të BE-së (në veçanti ato që e kanë njohur Kosovën deri më tani) vendimin e tyre do ta bazojnë mbi zbatimin e reformave.

Faktori tjetër që do të vendos ratifikimin e MSA-së do të jetë atmosfera e përgjithshme politike brenda BE-së si në tërësi, ashtu edhe në veçanti në shtetet anëtare.⁹⁰ Për më shumë, është e rëndësishme të theksohet që *sfidat e përgjithshme* në fazën e ratifikimit do të mbesin të njëjta me ato të fazës së negociimit. Me fjalë tjera, progres i mëtejshëm kërkohet në implementim të reformave në fusha dhe sektorë të ndryshëm (p.sh. sundimi i ligjit, institucionet politike, ekonomia e tregut të lirë, standardet Evropiane, etj).

Prandaj, duhet të theksohet që *sfida e parë e përgjithshme* në lidhje me fazën e ratifikimit të MSA-së ka të bëjë me ***implementimin e MP/MSA-së***. Edhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor janë ballafaquar me sfida të ngjashme në këtë aspekt. Për shembull, në vitin që Maqedonia ka nënshkruar MSA-në me BE-në, ka vazhduar të ballafaqohet me krizën politike, e cila ka pasur ndikim të madh në situatën ekonomike dhe institucionet vendore. Pas një krize të tillë, raporti i progresit të KE-së (2002) thekson që zbatimi i Marrëveshjes së Përkohshme është e rëndësishme së veçantë. Poashtu, progresi i mëtejshëm në këtë aspekt, lidhet me zbatimin e marrëveshjes.⁹¹ Një diskurs i ngjashëm lidhur me zbatimin e MP/MSA-së gjendet edhe në raportet vijuese të progresit, pas nënshkrimit të MSA-së me Shqipërinë në vitin 2005. Për shembull, raporti i progresit të KE-së për Shqipërinë (2007), thekson mungesën e vullnetit ndërmjet partive politike

⁸⁹ Nëse, në rastin e Kosovës do të mbahet ndonjë formë tjetër e ratifikimit (p.sh. MSA-ja për Kosovën të ratifikohet vetëm në nivelin institucional të BE-së), atëherë sfidat lidhur me fazën e ratifikimit do të jenë shumë më të vogla.

⁹⁰ Intervistë 3: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 28/02/2013); Intervistë 14: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 21/03/2013); Takimi i Tryezës së rumbullakët "Identifikimi i sfidave, mundësive dhe strategjive për negociata të mundshme dhe ratifikimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian". Organizuar nga RIDEA (14. 05. 2013).

⁹¹ Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2002) *Procesi i Stabilizimit Asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i Parë Vjetor*. E disponueshme:

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2002:0163:FIN:EN:PDF> (vizituar më: 30/06/2013).

për mbështetje të reformave të nevojshme dhe për përmbushje të obligimeve të MSA-së. Poashtu, në vitin 2008 (kur faza e ratifikimit të MSA-së me Shqipërinë ishte gati në përfundim) raporti i progresit të KE-së për Shqipërinë thekson faktin që asnjë progres nuk është bërë në Parlamentin e Shqipërisë sa i përket monitorimit dhe implementimit të obligimeve të MP/MSA-së.⁹²

Si në rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë, poashtu edhe në rastin e B&H, KE-ja ka vazhduar me mekanizmin kushtëzues në lidhje me zbatimin e MP/MSA-së, me qëllim të hyrjes në fuqi të MSA-së. Prandaj, MSA-ja ende nuk ka hyrë në fuqi, edhe pse është ratifikuar nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së në vitin 2010. Me fjalë tjera, është konsideruar e nevojshme që lidhshipi politik në Bosnje të zbaton kushtëzimet me qëllim të hyrjes në fuqi të MSA-së.⁹³

Vëmendje të veçantë nga KE-ja, sa i përket implementimit të MP/MSA-së reflektohet edhe në rastin e Malit të Zi dhe Serbisë. Kështu, raporti i progresit (2006) të KE-së thekson faktin që Mali i Zi vazhdon zbatimin e obligimeve në bazë të MSA-së; sidoqoftë duhet të vazhdoj me zhvillimin e kapaciteteve administrative me qëllim të zbatimit në të gjitha fushat që përfshihen nga MSA-ja.⁹⁴ Poashtu edhe në rastin e Serbisë, raporti i progresit (2012) të KE-së shënon që Serbia është duke përmbushur të gjitha përkushtimet e MP/MSA-së në fusha të tilla si tregu i brendshëm, konkurrenca, vënia e taksave, bujqësia dhe peshkataria, megjithatë ende duhet të vazhdohet me përmirësime të mëtejme në lidhje me administratën publike.⁹⁵ Në krahasim me rastet e mëparshme, nënshkrimi i MSA-së ndërmjet Kroacisë dhe BE-së ka pas efekt të menjëhershëm në programin e reformave. KE-ja (2002) raporton që progres i konsiderueshëm është arritur në fushën e demokratizimit, respektimit të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicës.⁹⁶ Si rezultat i këtij përkushtimi, edhe rruga e Kroacisë drejt BE-së, ishte më e përshpejtuar në krahasim me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor.

Prandaj, ky diskutim thekson rëndësinë që BE-ja i kushton zbatimit të MP/MSA-së gjatë fazës së ratifikimit të MSA-së në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst, Kosova duhet të nxjerr mësim dhe të merr masa parandaluese në adresim të *sfidës së parë të përgjithshme* që lidhet me *zbatimin e MP/MSA-së*.

⁹² Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2008) *Raporti i Progresit të Shqipërisë 2008*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/keydocuments/reports_nov_2008/albania_progress_report_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

⁹³ Komisioni Evropian (2012) *Raporti i Progresit të Bosnjës dhe Hercegovinës 2012*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ba_rapport_2012_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

⁹⁴ Shih fusnotën nr. 74.

⁹⁵ Komisioni Evropian (2012) *Raporti i Progresit të Serbisë 2012*. E disponueshme: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/sr_rapport_2012_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

⁹⁶ Shih fusnotën nr. 22.

Një numër tjetër të *sfidave të përgjithshme*, të cilat Kosova duhet t'i adresoj gjatë fazës ratifikuese të MSA-së lidhen edhe me *sfidat e përgjithshme* të fazës negociuese (p.sh., reforma në administratë publike, ekonomia e tregut të lirë, sundimi i ligjit, etj). Në thelb, me këto sfida janë ndeshur edhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor gjatë fazës ratifikuese të MSA-së. Për të ilustruar më konkretisht, në paragrafet e mëposhtme do të paraqesim disa shembuj nga rastet e Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë.

Gjatë fazës së ratifikimit, në rastin e Maqedonisë, një sfidë e rëndësishme ishte sistemi i dobët i gjyqësorit dhe korrupsioni, implementimi i reformave në administratën publike dhe zbatimi i të drejtave pronësore.⁹⁷ Poashtu në vitin 2005, vitin që MSA-ja hyri në fuqi, sistemi i dobët gjyqësor ka vazhduar të mbetet sfidë serioze për Kroacinë.⁹⁸ Ngjashëm me sfidat në sistemin e dobët gjyqësor, korrupsioni i përhapur dhe nevoja për reforma në administratë publike raportoheshin nga KE-ja gjatë fazës ratifikuese të MSA-së për Shqipërinë.⁹⁹

6.2. Sfidat Specifike

Siç është thënë më sipër, në krahasim me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, në rastin e Kosovës ekzistojnë dy *sfida tjera specifike* që lidhen me fazën ratifikuese të MSA-së.

Para se gjithash, përveç zbatimit eventual të MP/MSA-së dhe përmbushjes në masë të madhe të kriterëve të BE-së, sfida specifike pritet të rrjedhin nga *pesë shtetet anëtare të BE-së* që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Dhe, është e rëndësishme të theksohet që kjo sfidë do të jetë edhe më e dukshme gjatë fazës ratifikuese se sa në atë negociuese. Në veçanti, ky studim ka gjetur se vështirësi të veçanta priten nga Spanja dhe Qipro për shkak të pozicionit të tyre rigid në raport me pavarësinë e Kosovës. Në anën tjetër, një kurs veprimi më fleksibil pritet nga tri vendet tjera të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën. Me fjalë tjera, pritet që Greqia, Rumania dhe Sllovakia të jenë më pro-aktive dhe të hapura në këtë proces. Për më shumë, mund të ndodh që qëndrimet e vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën mund të ndryshojnë, duke pasur parasysh faktin që faza ratifikuese e MSA-së me Kosovën nuk do të filloj së paku në 18 muajt e ardhshëm nga publikimi i këtij studimi. Në këtë aspekt, mund të ndodh që disa shtete anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës të lëvizin përpara dhe të njohin Kosovën gjatë dy viteve të ardhshme. Poashtu, faktor tjetër në këtë aspekt është edhe atmosfera e përgjithshme politike në

⁹⁷ Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2004) *Procesi i Stabilizim Asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i Tretë Vjetor*. E disponueshme:

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2004:0202:FIN:EN:PDF> (vizituar më: 30/06/2013).

⁹⁸ Komisioni Evropian (2005) *Raporti i Progresit të Kroacisë 2005*. E disponueshme:

http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1424_final_progress_report_hr_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

⁹⁹ Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2007) *Raporti i Progresit të Shqipërisë 2007*. E disponueshme:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/albania_progress_reports_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

këto vende dhe partive që do të jenë në pozitë, gjë që do të jetë faktor vendimtar për ratifikim ose jo të MSA-së me Kosovën.¹⁰⁰

Sfida e dytë specifike për Kosovën gjatë fazës ratifikuese është e ngjashme me atë të fazës negociuese (p.sh., *raportet e Kosovës me Serbinë*). Me fjalë tjera, ky studim gjen se faktori që mund të shfrytëzohet për ose kundër gjatë fazës ratifikuese do të jetë progresi në dialog dhe raportet e përgjithshme me Serbinë.¹⁰¹ Duket sikur ekziston një përshtypje ndërmjet akterëve të rëndësishëm që Kosova duhet të përmirësoj raportet me Serbinë me qëllim që të lehtësoj procesin e ratifikimit në shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën.¹⁰²

6.3. Nën-përfundimet: Sfidat dhe mundësitë e Kosovës gjatë fazës eventuale të ratifikimit të MSA-së

Sikurse në rastin e fazës së negociatave të MSA-së, edhe në këtë pjesë janë identifikuar dy kategori të sfidave me të cilat Kosova mund të ballafaqohet gjatë fazës ratifikuese të MSA-së me BE-në: sfidat e përgjithshme dhe specifike/unike. Prandaj, *sfidat e përgjithshme* për Kosovën gjatë fazës së mundshme ratifikuese të MSA-së ishin të ngjashme me ato të vendeve të Ballkanit Perëndimor (p.sh., lidhur me zbatimin e MP/MSA-së dhe reformave të ndryshme duke filluar nga sundimi i ligjit, administrata publike, etj). Për më shumë, *sfidat specifike ose unike* në rastin e Kosovës ishin të njëjta me ato të fazës negociuese të MSA-së dhe lidheshin me mos-njohjen e shtetësisë së Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së, dhe mungesa e njohjes dhe raporteve të përgjithshme me Serbinë.

Megjithatë, *sfidat e përgjithshme* si në rastin e fazës negociuese, poashtu edhe gjatë fazës ratifikuese, paraqesin një mundësi që Kosova të përmirësoj qeverisjen e saj dhe cilësinë e jetës së qytetarëve të saj. Me fjalë tjera, ratifikimi i MSA-së me Kosovën do të ndihmoj që Kosova të zhvilloj mëtej sistemin e saj ekonomik dhe politik në linjë me standardet Evropiane.

Për më shumë, kjo do të ndihmoj që Kosova të kaloj në fazën e ardhshme të proceseve integruese Evropiane (p.sh., të aplikoj për statusin e vendit kandidat dhe eventualisht të filloj negociatat për aderim me BE-në). Përfundimisht, procesi ratifikues i suksesshëm i MSA-së me BE-në, do të ndihmoj në krijimin e një të ardhme dhe prosperiteti më të mirë për qytetarët e Kosovës.

¹⁰⁰ Intervistë 4: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 5: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 14: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 21/03/2013).

¹⁰¹ Intervistë 13: Zyrtar i Lartë, Oda Ekonomike e Kosovës (Prishtinë, 15/03/2013).

¹⁰² Intervistë 1: Zyrtar, EUSR (Prishtinë, 22/02/2013); Takimi i Tryezës së rumbullakët "Identifikimi i sfidave, mundësive dhe strategjive për negociatat të mundshme dhe ratifikimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian". Organizuar nga RIDEA (14. 05. 2013); Intervistë 2: Zyrtar i Lartë, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (Prishtinë, 26/02/2013); Intervistë 3: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 28/02/2013); Intervistë 5: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013); Intervistë 16: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 25/03/2013); Intervistë 19: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 22/04/2013).

7. Përfundimet

Që nga viti 1999, BE-ja propozoi themelimin e PAS për vendet e Ballkanit Perëndimor, si kornizë për udhëzim të përpjekjeve aderuese.¹⁰³ Parimet kyçe të PAS janë të shënuara në Komunikatën e Komisionit në maj të vitit 1999 dhe ishin konfirmuar nga Këshilli në qershor të vitit 1999. Nëpërmjet këtij procesi, BE-ja shpreh vendosmërinë e saj që të pranon sfidën dhe përgjegjësinë për të kontribuar në paqen, stabilitetin dhe mirëqenie në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në thelb, që nga atëherë PAS është vërtetuar si tregim i suksesshëm për pjesën më të madhe të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, në rastin e Kosovës ky proces është zgjatur dhe shtyrë deri në ditët e sotme. Kohëve të fundit, Këshilli Evropian ka vendosur të filloj negociatat për MSA-në me Kosovën. Dhe, në këtë studim janë adresuar sfidat me të cilat mund të ballafaqohet Kosova gjatë fazës negociuese të MSA-së dhe fazës së mundshme ratifikuese të MSA-së.

Është e rëndësishme të theksohet që përfundimet e këtij studimi bazohen në analizë të raporteve të ndryshme të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të dhëna të mbledhura nga intervistat dhe diskutimeve në tryezë të rrumbullakët me akterë të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar, duke përfshirë praninë diplomatike në Kosovë, studiues dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Kështuqë, *pjesa e parë* e këtij studimi ka paraqitur sfondin e përfshirjes së BE-së në Ballkanin Perëndimor, e që më konkretisht lidhet me kushtet e Këshillit të definuar në konkluzionet e tij të 29 prillit 1997 dhe 21 dhe 22 qershor 1999, përmbajtjen e deklaratës përfundimtare të Samitit të Zagrebit më 24 nëntor 2000, dhe agjendën e Selanikut të 19 dhe 20 qershor 2003. Në këtë aspekt, vlerësimi i progresit në secilin vend të Ballkanit Perëndimor bëhet nëpërmjet mekanizmave të përcaktuar sipas PAS, veçanërisht Raporteve vjetore të Progresit të KE-së.

Pjesa vijuese e studimit ka përfshirë analizën e raporteve ndërmjet Kosovës dhe BE-së, duke krahasuar atë me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Kjo pjesë e studimit ka gjetur se Kosova mbetet vendi i fundit në Ballkanin Perëndimor pa marrëdhënie kontraktuale me BE-në (dhe situata mbetet e tillë edhe pas periudhës së pavarësisë).

Pjesët vijuese të këtij studimi janë marrë me raportet Kosovë – BE (1999-2013). Në këtë aspekt, është gjetur se me praninë e madhe të saj në Kosovë, BE-ja ka përmbushur dy role kryesore (1999-2008). E para lidhet me mbështetjen financiare në Kosovë dhe e dyta lidhet me përkushtimin e BE-së në nxitje të stabilitetit, paqes dhe perspektivës Evropiane për Kosovën dhe më gjerë në Ballkanin Perëndimor. Në anën tjetër, Deklarimi i Pavarësisë së Kosovës, në shkurt

¹⁰³ Republika e Kosovës (2012) *Plani i Veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit*. E disponueshme: <http://www.mei-ks.net/repository/docs/Englisht.pdf> (vizituar më 30. 06. 2013).

2008, ka shënuar një fillim të ri në raportet BE – Kosovë, në veçanti lidhur me procesin rikonfigurues të pranisë së BE-së në Kosovë. Në vitin 2009, raportet BE – Kosovë kanë shënuar progres të mëtejshëm, nëpërmjet propozimit të Komisionit në vitin 2009 për forcimin dhe zgjerimin e pjesëmarrjes së Kosovës në PAS nëpërmjet krijimit të një mekanizmi të një dialogu të qëndrueshëm për PAS. Për më shumë, në vitin 2012 pak progres është shënuar në raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së dhe kjo kryesisht lidhet me lansimin dhe prezantimin e udhërrëfyesit për liberalizim të vizave dhe publikimin e studimit të fizibilitetit në Kosovë, nga BE-ja. Këto raporte janë konsoliduar më shumë në prill të vitit 2013, kur Komisioni Evropian i propozoi Këshillit që të vendos mbi autorizimin e hapjes së negociatave për MSA ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Përfundimisht, raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së arritën kulmin me vendimin e Këshillit të BE-së (qershor, 2013) për fillimin e negociatave me Kosovën për MSA-në.

Në këtë kontekst, *pjesët tjera* të këtij studimi paraqiten sfidat me të cilat mund të ballafaqohet Kosova gjatë fazës negociuese dhe eventualisht ratifikuese të MSA-së me BE-në.

Pjesa lidhur me fazën e negociatave të MSA-së, ka identifikuar dy kategori të sfidave me të cilat Kosova mund të ballafaqohet gjatë këtij procesi: sfidat e përgjithshme dhe specifike/unike. *Sfidat e përgjithshme* të Kosovës gjatë kësaj faze përbëhen nga çështje duke filluar si sundimi i ligjit, funksionimi i ekonomisë së tregut dhe reforma në administratë publike. Për më shumë, *sfidat specifike ose unike* lidheshin me mos-njohjen e shtetësisë së Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së dhe mungesa e njohjes dhe raportet e përgjithshme me Serbinë.

Në të njëjtën kohë, sikurse në rastin e fazës negociuese të MSA-së, poashtu edhe gjatë fazës ratifikuese të MSA-së, ky studim ka identifikuar dy kategori të sfidave për Kosovën: sfidat e përgjithshme dhe specifike/unike. *Sfidat e përgjithshme* të Kosovës gjatë fazës së mundshme ratifikuese të MSA-së ishin të ngjashme me ato të vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor (p.sh., lidhur me zbatimin e MP/MSA-së dhe reformave të ndryshme në çështje si të sundimit të ligjit, administratës publike, etj). Për më shumë, *sfidat specifike ose unike* në rastin e Kosovës ishin të njëjta me ato të identifikuar në fazën negociuese të MSA-së dhe lidheshin me mos-njohjen e shtetësisë së Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së dhe mungesa e njohjes dhe raportet e përgjithshme me Serbinë.

Sidoqoftë, gjatë dy fazave (negociuese dhe ratifikuese) të MSA-së, *sfidat e përgjithshme* të identifikuar paraqesin një mundësi që Kosova të përmirësojë qeverisjen e saj dhe cilësinë e jetës së qytetarëve të saj. Me fjalë tjera, MSA-ja është një mundësi unike që Kosova të thellojë stabilitetin e brendshëm dhe forcojë institucionet e saj. Gjatë këtij procesi, BE-ja do të rris mbështetjen financiare dhe teknike për Kosovën nëpërmjet ofrimit të ekspertizës dhe mbështetjeje për ndërtim të kapaciteteve të institucioneve të Kosovës. Për më tepër, legjislacioni i Kosovës do të përafrohet me atë të BE-së, gjë që do të vendos Kosovën në rrugën e duhur drejt

qëllimeve të integritimit Evropian. Poashtu, kjo paraqet një mundësi që ndërmarrjet e Kosovës të depërtojnë në tregun e BE-së dhe në tërheqje të investimeve të jashtme (në veçanti Evropiane) dhe në një mënyrë të përmirësimit gjendjen e përgjithshme ekonomike. Shkurtimisht, MSA-ja do të ndihmojë që Kosova të zhvillojë sistemin ekonomik dhe politik në pajtim me standardet Evropiane.

Prandaj, nëpërmjet reformave pozitive në institucione, legjislacion dhe ekonomi, në përgjithësi do të paraqitet edhe mundësia për përmirësim të jetës së qytetarëve. Sigurisht, MSA-ja nuk do të ndryshojë gjendjen e përgjithshme të sistemit ekonomik dhe politik në Kosovë. Megjithatë, nëse merret me seriozitet nga institucionet e Kosovës – mund të shërbejë si një hap i vogël dhe/ose fillestar në këtë drejtim ose rrugë. Përfundimisht, përmbyllja e suksesshme e fazës negociuese dhe ratifikuese të MSA-së, ndihmon që Kosova të lëviz përpara në fazën vijuese të proceseve të integritimit Evropian (p.sh., të aplikojë për statusin e vendit kandidat dhe eventualisht të hap negociatat e anëtarësimit me BE-në). Me qëllim të përmbylljes së suksesshme të këtij procesi (negocimit dhe ratifikimit të MSA-së), pjesa vijuese e këtij studimi ofron një sërë rekomandimesh konkrete.

8. Rekomandimet

Rekomandimet e këtij studimi përmbledhen në dy kategori komplementare: **(i)** kategoria e parë e rekomandimeve ka të bëjë me mënyrën e adresimit të *sfidave të përgjithshme* të identifikuar gjatë fazës negociuese dhe ratifikuese të MSA-së; dhe **(ii)** kategoria e dytë e rekomandimeve ka të bëjë me kursin e veprimit që institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin, me qëllim të adresimit të *sfidave specifike* të identifikuar gjatë dy fazave të MSA-së. Para se gjithash, këto rekomandime janë për Qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera vendore (veçanërisht Ministrinë e Integritimit Evropian). Për më shumë, këto rekomandime mund të shërbejnë edhe për BE-në dhe organizatat tjera ndërkombëtare në Kosovë.

8.1. Rekomandimet në lidhje me sfidat e përgjithshme për fazën negociuese dhe ratifikuese të MSA-së

Për të arritur një proces të suksesshëm negociues dhe ratifikues të MSA-së, Kosova duhet të bëjë përpjekje në përcaktim të proceseve konkrete të politik-bërjes dhe implementimit të tyre, me qëllim të adresimit të *sfidave të përgjithshme dhe specifike* të cilat do të paraqiten gjatë dy fazave të MSA-së. Në këtë aspekt, rekomandimet vijuese mund të jenë të dobishme:

- Gjetjet e këtij studimi sugjerojnë që për një proces të suksesshëm negociues dhe ratifikues të MSA-së, Kosova duhet të ndërmerr reforma në fusha dhe sektorë të ndryshme në pajtim me standardet Evropiane. Këto reforma lidhen me fushën e sundimit të ligjit, administratës publike, ekonomisë së tregut të lirë, institucioneve politike, etj;

- Në këtë aspekt, qeveria e Kosovës duhet të forcoj nivelin e mesëm menaxherial të *administratës publike*, rris profesionalizmin, dhe zvogëloj ndërhyrjen politike në këtë sektor;
- Një sërë reformash tjera lidhet me fushën e *sundimit ligjor*. Institucionet e Kosovës duhet të arrijnë rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për më shumë, duhet të forcohen sistemi gjyqësor dhe zvogëlohet ndërhyrja politike. Poashtu, ballafaqimi me krimet e luftës në mënyrë të suksesshme do të jetë një sfidë tjetër për Kosovën gjatë këtij procesi;
- Sektori tjetër që kërkon reforma ka të bëjë me fushën e ekonomisë. Kosova duhet të përcaktoj një *ekonomi të plotë funksionale*. Më konkretisht, qeveria e Kosovës duhet të zvogëloj sektorin jo-formal, përmirësoj mjedisin biznesor që operon në Kosovë dhe nxis zhvillimin e sektorit privat;
- Në nëntor të vitit 2013, institucionet relevante të Kosovës duhet të organizojnë zgjedhje lokale të lira, të drejta dhe demokratike, të cilat mund të konsiderohen si një shenjë e rritjes së pjekurisë të *institucioneve politike* të Kosovës;
- Nëse Kosova do të menaxhon një proces të suksesshëm negociues dhe nënshkruan MSA-në me BE-në, duhet që të respektoj dhe zbatoj në tërësi MP/MSA-në dhe obligimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje. Me fjalë tjera, MSA-ja nuk duhet të shihet vetëm si një ushtrim i plotësimit të një kutie me kritere;
- Me qëllim të zbatimit të reformave të lartë përmendura në politikat përkatëse, dhe që të mund të zbatoj MP/MSA-në, Kosova duhet të caktoj burime shtesë financiare dhe njerëzore dhe duhet të shmang politizimin e procesit të MSA-së. Në këtë kontekst, Kosova duhet të krijoj ekipe të përziera të udhëheqësish teknik (ekspert të fushës, pa marrë parasysh sfondin e tyre politikë) dhe politik;
- Ky proces kërkon ndërveprim të disa institucioneve në Kosovë. Në këtë aspekt, ekipi udhëheqës për MSA-në duhet të krijoj mekanizma të domosdoshëm për koordinim të institucioneve të ndryshme vendore (p.sh., Parlamenti i Kosovës dhe komitetet përkatëse) dhe partnerëve tjerë relevant;
- Poashtu, për të arritur proces të suksesshëm negociues dhe ratifikues, Kosova duhet të rris bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë dhe praninë e tyre në Kosovë. Në këtë mënyrë, Kosova duhet të kërkoj shfrytëzimin e mbështetjes financiare të akterëve ndërkombëtarë (p.sh., USAID) në përmirësim të disa sektorëve që janë të rëndësishëm për MSA-në (p.sh., sundimi i ligjit, ekonomia e tregut të lirë, etj);

- Në të njëjtën kohë, ekziston nevoja për ngritje të vetëdijes në Kosovë në lidhje me standardet e BE-së. Në këtë aspekt, qeveria e Kosovës duhet të organizoj fushata publike dhe të komunikoj me qytetarët e saj në lidhje me vlerat, parimet dhe rregullat e BE-së. Në fakt, ky proces ka të bëjë me përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe si pasojë ata duhet të informohen më shumë për këtë proces. Dhe, përfundimisht reformat dhe procesi i modernizimit duhet të shihen si procese të domosdoshme për shoqërinë e Kosovës, më shumë se sa kërkesa të kushtëzuara nga BE-ja;
- Për më shumë, Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera relevante duhet të komunikojnë më shumë me qytetarët dhe bizneset (p.sh., si të depërtojnë në treg të BE-së) për përparësitë dhe mundësitë që ofron MSA-ja për ta. Kjo do të forcoj shpirtin e komunitetit dhe nxit kohezionin në tërë shoqërinë; dhe
- Përfundimisht, Kosova duhet dhe ka një mundësi të shkëlqyer për të mësuar nga shembujt dhe përvojat e vendeve tjera (vendet e Ballkanit Perëndimor). Sikurse është identifikuar në këtë studim, sfidat e përgjithshme me të cilat Kosova do të ballafaqohet gjatë fazës negociuese, janë tejkaluar nga vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Në këtë aspekt, ‘mekanizmi i mësimave të nxjerrura’ duhet të zbatohet praktikisht nga institucionet e Kosovës;

8.2. Rekomandimet në lidhje me *sfidat specifike* gjatë fazës negociuese dhe ratifikuese të MSA-së

Ky studim ka identifikuar dy *sfida specifike ose unike* gjatë fazës negociuese dhe ratifikuese të MSA-së: mos-njohja e shtetësisë së Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së dhe mungesa e njohjes dhe raporteve të përgjithshme me Serbinë. Megjithatë, për të adresuar këto *sfida specifike*, ky studim ofron rekomandimet vijuese:

- Me qëllim të lehtësimit të procesit ratifikues të MSA-së, qeveria e Kosovës përveç zbatimit të MP/MSA-së, duhet të zgjeroj procesin lobues në nivele të ndryshme. Ky studim ka identifikuar së paku *tri* nivele të tilla;
- **Niveli i parë** është procesi lobues i cili duhet të bëhet në institucione të BE-së në Bruksel dhe tek prezenca e tyre përkatëse në Kosovë;
- **Niveli i dytë** ka të bëjë me lobimin e drejtpërdrejt ose indirekt tek pesë shtetet anëtare mos-njohëse të pavarësisë së Kosovës.¹⁰⁴ *Lobimi i drejtpërdrejt* duhet të bëhet nga Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me botën akademike, sektorin e biznesit dhe shoqërisë civile. Nëpërmjet këtij lobimi, shtetet anëtare që nuk e kanë njohur Kosovën

¹⁰⁴ Nëse ky numër nuk zvogëlohet me kalimin e kohës.

duhet të informohen dhe t'ju qartësohet se ratifikimi i MSA-së me Kosovën nuk paraqet precedent për raste tjera (p.sh., Qipro Veriore). Në anën tjetër, *lobimi indirekt* duhet të bëhet nga Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me shtetet anëtare të BE-së që e kanë njohur Kosovën dhe janë përkrahës të mëdhenj të Kosovës (p.sh., Gjermania, Franca, Britania e Madhe, etj);

- Përfundimisht, *niveli i tretë* ka të bëjë me idenë e bërjes së Kosovës të *dukshme* (vizibël) jo vetëm tek shtetet që nuk e kanë njohur brenda BE-së, por edhe tek shtetet anëtare të BE-së që e kanë njohur Kosovën. Një mënyrë për ta arritur këtë është nëpërmjet përmirësimit të qeverisjes së brendshme dhe bartjes së këtij lajmi jashtë (në veçanti në shtetet anëtare kryesore të BE-së). Mënyra tjetër është nëpërmjet organizimit dhe vizitave institucionale në institucionet nacionale të shteteve të ndryshme anëtare të BE-së (p.sh., delegacionet parlamentare të Kosovës të vizitojnë parlamentet nacionale të shteteve të ndryshme të BE-së dhe e kundërta, ndërveprimi i shoqërisë civile, etj). Me këtë sigurohet dhe forcohet procesi që ratifikimi i MSA-së me Kosovën të integrohet në agjenda të ndryshme të shteteve anëtare të BE-së;
- Në anën tjetër, me qëllim të adresimit të suksesshëm të sfidës së *raporteve me Serbinë*, qeveria e Kosovës duhet të jetë e përkushtuar në dialog të vazhdueshëm me Serbinë dhe duhet të normalizoj më tej marrëdhëniet fqinjësore. Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton që Kosova duhet të bëjë kompromise dhe sakrificat të dëmshme për shtetësinë, me qëllim të kënaqjes së qeverisë Serbe apo dikujt tjetër. Sepse, nëse kjo ndodh, (dobësimi i shtetit të sapo krijuar Kosovë) atëherë, edhe domethënia e proceseve integruese Evropiane mund të jetë e pakuptimshme;
- Poashtu, qeveria e Kosovës duhet të jetë më pro-aktive në angazhimin e një dialogu civil me Serbët etnik në Veri të Kosovës, dhe krijimit të një shoqërie më tolerante dhe kohezive brenda territorit të Kosovës. Shoqëria civile e Kosovës mund të luaj një rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Sa më kohezive të bëhet shoqëria e Kosovës, aq më pak hapësirë mbetet për ndikimin dhe përfshirjen e qeverisë Serbe në Kosovë (veçanërisht në Veri të Kosovës);
- Brenda kornizës së dialogut në Bruksel dhe më gjerë brenda kornizës së normalizimit të raporteve ndërmjet Serbëve dhe Shqiptarëve, ky mund të jetë një moment i veçantë i adresimit të çështjes së Shqiptarëve që jetojnë në luginën e Preshevës; dhe
- Përfundimisht, një qasje gjithëpërfshirëse në dialog të vazhdueshëm nga të dyja anët do të ndihmojë që të dyja vendet të lëvizin përpara me agjendën e tyre Evropiane dhe të krijojnë një të ardhme më paqësore dhe më të mirë për gjeneratat e ardhshme. Në fund të fundit, qëllimi përfundimtar i dialogut të vazhdueshëm nuk duhet të jetë vetëm vendosja e

flamujve të Kosovës dhe Serbisë para ndërtesave të BE-së. Por, qëllimi përfundimtar duhet të jetë brendësimi i standardeve, parimeve dhe vlerave të BE-së nga qytetarët e të dyja vendeve dhe tërë rajoni i Ballkanit Perëndimor.

9. Bibliografia

Agjencioni Evropian për Rindërtim (2006) *Raporti Tremujor i Aktivitetit*. E disponueshme: www.AER.europa.eu/publications/main/AER-ActivityReports-Quarterly-ApriltoJune2006.htm (vizituar më 30/06/2013).

Biermann R. (2002) 'Perspektiva e Robert Schuman për Paqe dhe Stabilitet përmes Pajtimeve', *Rishqytimi Euro-Atlantik*, Vëll. 1 Nr.1, fq. 71.

Intervistë 1: Zyrtar, EUSR (Prishtinë, 22/02/2013).

Intervistë 2: Zyrtar i Lartë, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (Prishtinë, 26/02/2013).

Intervistë 3: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 28/02/2013).

Intervistë 4: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013).

Intervistë 5: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 01/03/2013).

Intervistë 6: Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës (Prishtinë, 01/03/2013).

Intervistë 7: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 05/03/2013).

Intervistë 8: Ambasador i Italisë në Kosovë (Prishtinë, 06/03/2013).

Intervistë 9: Zyrtar i Lartë Politik, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë / Përfaqësuesi Special i BE-së (Prishtinë, 08/03/2013).

Intervistë 10: Zyrtar Politik, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë / Përfaqësuesi Special i BE-së (Prishtinë, 08/03/2013).

Intervistë 11: Anëtar i Parlamentit në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 11/03/2013).

Intervistë 12: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 13/03/2013).

Intervistë 13: Zyrtar i Lartë, Oda Ekonomike e Kosovës (Prishtinë, 15/03/2013).

Intervistë 14: Diplomati Evropian në Kosovë (Prishtinë, 21/03/2013).

Intervistë 15: Diplomati Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 22/03/2013).

Intervistë 16: Diplomat Perëndimor në Kosovë (Prishtinë, 25/03/2013).

Intervistë 17: Zyrtar i Lartë, Ministria e Punëve të Jashtme (Prishtinë, 29/03/2013).

Intervistë 18: Hulumtues mbi Integrimin në BE (Prishtinë, 10/04/2013).

Intervistë 19: Diplomat Evropian në Kosovë (Prishtinë, 22/04/2013).

Intervistë 20: Zyrtar i Lartë, Ministria e Integritimit Evropian (Prishtinë, 24/04/2013).

Intervistë 21: Zyrtar i Lartë, Zyra e Kryeministrit të Kosovës (Prishtinë, 5/04/2013).

Intervistë 22: Aktivist i Shoqërisë Civile (Prishtinë, 26/04/2013).

Intervistë 23: Ligjërues i të Drejtës Evropiane dhe Ndërkombëtare, Universiteti Prishtinës (Prishtinë, 29/04/2013).

Intervistë 24: Hulumtues mbi Çështje të BE-së (Prishtinë, 30/04/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (1999) *Komunikatë nga Komisioni për Këshillin dhe Parlamentin Evropian për procesin e Stabilizim-Asociimit për vendet e Evropës Jug-Lindore*. E disponueshme: <http://aei.pitt.edu/3571/1/3571.pdf> (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2000) *Komunikatë nga Komisioni për Këshillin për Konkluzionet Operative të procesit të Stabilizim Asociimit të BE-së për vendet e Evropës Jug-Lindore*. E disponueshme: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2000:0049:FIN:EN:PDF> (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2002) *Procesi i Stabilizim Asociimit për Evropën Juglindore - Raporti i Parë Vjetor*. E disponueshme: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2002:0163:FIN:EN:PDF> (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2004) *Procesi i Stabilizim Asociimit për Evropën Juglindore. Raporti i Tretë Vjetor*. E disponueshme: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2004:0202:FIN:EN:PDF> (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2009) *Përmbushja e Perspektivës Evropiane të Kosovës*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2007) *Raporti i Progresit të Shqipërisë 2007*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/albania_progress_reports_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2008) *Raporti i Progresit të Shqipërisë 2008*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/keydocuments/reports_nov_2008/albania_progress_report_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2007) *Raporti i Progresit të Bosnjës dhe Hercegovinës 2007*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/bosnia_herzegovina_progress_reports_en.pdf (vizituar më: 14/06/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2006) *Raporti i Progresit të Malit të Zi 2006*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2006/nov/mn_sec_1388_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2007) *Raporti i Progresit të Serbisë 2007*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/serbia_progress_reports_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Këshilli i Bashkimit Evropian (2011) *Konkluzionet e Këshillit mbi zgjerimin dhe procesin e stabilizim asociimit*. E disponueshme:
http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/126577.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2005) *Raporti i Progresit të Shqipërisë 2005*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1421_final_progress_report_al_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2012) *Raporti i Progresit të Bosnjës dhe Hercegovinës 2012*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ba_rapport_2012_en.pdf
(vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2005) *Raporti i Progresit të Kroacisë 2005*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1424_final_progress_report_hr_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2005) *Një e ardhme Evropiane për Kosovën*. COM 156 final.

Komisioni Evropian (2005) *Raporti i Progresit të Kosovës* 2005*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1423_final_progress_report_ks_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2006) *Raporti i Progresit të Kosovës* 2006*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2006/nov/ks_sec_1386_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2007) *Raporti i Progresit të Kosovës* 2007*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/kosovo_progress_reports_en.pdf
(vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2008) *Raporti i Progresit të Kosovës* 2008*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/keydocuments/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2009) *Raporti i Progresit të Kosovës* 2009*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2010) *Raporti i Progresit të Kosovës* 2010*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf
(vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2011) *Raporti i Progresit të Kosovës* 2011*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf
(vizituar më 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2012) *Raporti Analitik i Kosovës 2012*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf
(vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2012) *Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf
(vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2012) *Vendet në Zgjerim, datat kyçe në rrugën e Shqipërisë drejt BE-së*. E disponueshme:
http://eeas.europa.eu/delegations/albania/eu_albania/political_relations/index_en.htm (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Bosnja dhe Hercegovina*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/bosnia-herzegovina/index_en.htm (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Kroacia*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/croatia/index_en.htm
(vizituar më 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/former-yugoslav-republic-of-macedonia/index_en.htm (vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Mali i Zi*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-countryinformation/montenegro/index_en.htm
(vizituar më 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2012) *Raporti i Progresit të Serbisë 2012*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/sr_rapport_2012_en.pdf
(vizituar më: 30/06/2013).

Komisioni Evropian (2013) *Vendet në zgjerim, Serbia*. E disponueshme:
http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/serbia/index_en.htm
(vizituar më: 30/06/2013).

Markiewicz, M. dhe Ivana, V. (2006) *Kostot potenciale fiskale të Malit të Zi për pranimin në BE. Seria e punimeve. Instituti për Studime Strategjike dhe Prognoza*. E disponueshme:

http://issp.me/wp-content/uploads/2013/04/2006-WP_Fiscal-Cost-of-EU-Accession.pdf (vizituar më: 30/06/2013).

Parlamenti Evropian (2011) *Vendet e Ballkanit Perëndimor*. E disponueshme:

http://www.europarl.europa.eu/aboutparliament/en/displayFtu.html?ftuId=FTU_6.4.1.html

(vizituar më 30/06/2013).

Pippan, C. (2004) 'Rruga e lëkundshme drejt Evropës: Procesi i Stabilizim Asociimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Parimi i Kushtëzimit', *Rishqyrtimi i Çështjeve të Jashtme Evropiane* 9, fq. 219–245.

Qerimi, Q. (2002) 'Integrimi i Evropës Jug-lindore në BE: Ëndrra dhe realitete', *Rishqyrtimi i Evropës Jug-Lindore*, Vëll. 1 Nr. 1.

Republika e Kosovës (2012) *Plani i Veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit*. E disponueshme: <http://www.mei-ks.net/repository/docs/Anglisht.pdf> (vizituar më 30/06/2013).

Takimi i Tryezës së rrumbullakët: 'Identifikimi i sfidave, mundësive dhe strategjive për negociata të mundshme dhe ratifikimin e procesit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian'. Organizuar nga RIDEA (14/05/2013).

Voss, J. (2002) "Bashkimi Evropian, dje, sot dhe nesër ", *Rishqyrtimi Euro-Atlantik*, Vëll. 1 Nr. 1.

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (2006) *Faqja Zyrtare*. E disponueshme: http://www.delprn.ec.europa.eu/en/about_us/role.htm (vizituar më: 30/06/2013).

10. Anekset

10. 1. Pyetësi

‘Procesi i mundshëm negociues dhe ratifikues për MSA-në ndërmjet BE-së dhe Kosovës: Sfidat dhe Mundësitë – Pyetjet për Intervistë’

Ju lutem, vëreni që pyetjet vijuese janë udhëzuese dhe kanë për qëllim të paraqesin një bazë për diskutim jo-formal. Nuk supozojmë që të intervistuarit mund të përgjigjen në të gjitha pyetjet e mëposhtme.

Pyetje personale

1. Sa kohë punoni në pozitën aktuale?
2. Sa kohë punoni në fushën e integrimi të BE-së?

Raportet BE-Kosovë

1. Gjerësisht, si i definoni raportet aktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së?
2. Sipas mendimit tuaj, cilat janë ngjarjet më kryesore ose zhvillimet në kontekstin e raporteve Kosovë-BE?
3. Sipas mendimit tuaj, cilat janë aspektet më të vështira të raporteve Kosovë-BE?
4. Sipas mendimit tuaj, cili është roli më i rëndësishëm që ka shfaqur BE-ja në Kosovë që nga viti 1999 (sukseset vs. dështimet)?

Negociatat për MSA-në

1. Kur prisni që Kosova të jetë e gatshme të filloj negociatat me BE-në në lidhje me MSA-në?
2. Çfarë prisni se do të jenë *tri sfidat kryesore* në lidhje me negociatat për MSA-në ndërmjet Kosovës dhe BE-së? A mund të jeni specifik, në këtë aspekt?
3. A ekziston përplasje/ndeshje politikash ndërmjet agjencive të ndryshme të BE-së që operojnë në Kosovë (EULEX, EUSR, etj)?
4. A është BE-ja unike në lidhje me negociatat për MSA-në me Kosovën?
5. Cilat janë mundësitë e Kosovës në lidhje me procesin e mundshëm negociues për MSA?

Ratifikimi i MSA-së

1. Kur prisni që BE të jetë e gatshme të filloj procesin e ratifikimit të MSA-së me Kosovën?

2. Çfarë prisni se do të jenë *tri sfidat kryesore* në lidhje me procesin e mundshëm ratifikues të MSA-së për Kosovën? A mund të jeni specifik, në këtë aspekt?
3. Cilat janë mundësitë e Kosovës në lidhje me procesin e mundshëm ratifikues të MSA-së?

Rekomandimet

1. Çfarë do të ishin *tri rekomandimet kryesore* që do t'i sugjeroni institucioneve të Kosovës në lidhje me procesin e mundshëm *negociues* për MSA-së?
2. Çfarë do të ishin *tri rekomandimet kryesore* që do t'i sugjeroni institucioneve të Kosovës në lidhje me procesin e mundshëm *ratifikues* të MSA-së?

10.2. Agjenda e Tryezës së Rrumbullakët

'Identifikimi i sfidave, mundësive dhe strategjive për procesin e mundshëm negociues dhe ratifikues të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian'

09:30 – 09:45 Regjistrimi dhe Kafe

09:45 – 10:30 Prezantimi i Gjetjeve Fillestare të Studimit
Hulumtuesit e RIDEA-s

10:30 – 10:45 Pauze për Kafe

10:45 – 12:15 Diskutimet
Moderator i RIDEA-s

12:15 – 12:30 Pauze për Kafe

12:30 – 13:15 Përfundimet e Tryezës së Rrumbullakët